

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Gjirokastrë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar

të ushtruar në

BASHKINË GJIROKASTËR

Tiranë, gusht 2024

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-------------------------------------|
| SHKURTIME | 3 |
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| 1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 11 |
| II. HYRJE | 12 |
| III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | 17 |
| 1. Informacion i përgjithshëm mbi BashkinëGjirokastrë | 17 |
| 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit. | 18 |
| 2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. | 18 |
| 2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit | 22 |
| 2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar..... | 38 |
| 2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM | 47 |
| 2.5. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm | 51 |
| 2.6. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit | 65 |
| IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET | 65 |
| A. MASA ORGANIZATIVE | 65 |
| B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA) | 74 |
| C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH..... | 74 |
| D. MASA DISIPLINORE | 75 |
| V. ANEKSET | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Auditimin e Brendshëm | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi të ardhurat | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Pasqyrat Financiare | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Pronat Publike..... | Error! Bookmark not defined. |

SHKURTIME

| | |
|----------------|---|
| AAJM | Aktive Afatgjata Jo Materiale |
| AAM | Aktive Afatgjata Materiale |
| AK | Autoritet Kontraktor |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| GMS | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IMTV | Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor |
| INOTSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IPSAS | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| ISA | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IT | Teknologjia e Informacionit |
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| KKT | Këshilli Kombëtar i Territorit |
| KPP | Komisioni i Prokurimit Publik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| LP | Listëpagesa |
| LPP | Ligji i Prokurimit Publik |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| MF | Ministria e Financave |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NJA | Njësi Administrative |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| OE | Operator Ekonomik |
| PF | Pasqyrat Financiare |
| QKB | Qendra Kombëtare e Biznesit |
| SHA | Shoqëri Anonime |
| ShPK | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar |
| SKK | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| UMFE | Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Gjirokastër:

Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 25,301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil ajo numëron 52,054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km², me një densitet prej 53.91 banorë/km² sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrit Civil.

Për vitin 2023, buxheti vjetor është miratuar me VKB nr. 100, datë 16.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1238/1 prot., datë 29.12.2022.

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2023, nga 1,435,644 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,156,416 mijë lekë ose në masën 80.5%, (Pagat (600) nga 437,194 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 399,612 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhurat e veta 76,751 mijë lekë, granti 109,594 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar 204,189 mijë lekë, të deleguara 5,408 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar 3,670 mijë lekë) ose 91%, sigurimet shoqërore (601) nga 68,925 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 65,896 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhura e veta 10,832 mijë lekë, granti 18,488 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar 35,712 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar 864 mijë lekë) ose 96%, Shpenzimet operative (602) nga 183,374 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 151,486 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhura e veta 64,351 mijë lekë, granti 26,459 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar 60,254 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara 136 mijë lekë dhe të kushtëzuara 286 mijë lekë) ose 83% dhe shpenzimet për investime (230-231) nga 511,337 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 317,503 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhurat e veta 91,134 mijë lekë, granti 73,322 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar specifike 4,211 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar 148,836 mijë lekë) ose 63%.

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë planifikuar për t'u përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 483,954 mijë lekë (Të ardhura të vitit në shumën 230,477 mijë lekë dhe granti 253,364 mijë lekë) ose në masën 68.5% nga transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 222,149 mijë lekë ose në masën 31.5%.

Për sa i përket shpenzimeve, nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 65% ose në vlerën 462,249 mijë lekë, shpenzimet korrente zënë 22.6% ose për vlerën 159,960 mijë lekë dhe shpenzimet për investime zënë 12% ose në vlerën 83,781 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhërin nr. 945, datë 07.12.2022. Numri maksimal i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 98, datë 16.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1219/1 prot., datë 20.12.2022, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. 2, datë 04.01.2023

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Bashkia e Gjirokastrës është njësi vendore e pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale përbëhet nga ish Bashkia Gjirokastër dhe ish komunat Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrie dhe Antigone, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 10, Ligjit nr. 68/2017,

datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të auditimeve për muajin maj 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87/4 prot., datë 10.05.2024.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregulator në fuqi;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 8 gjetje dhe ka dhënë 12 rekomandime, nga të cilat masa organizative 6 gjetje me 9 rekomandime, masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) 1 gjetje me 1 rekomandim dhe masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash 1 gjetje me 2 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për

llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori.

Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre.

Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2. Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime nga vlera 1,435,644 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,156,416 mijë lekë ose 80.5, për shkak të mosanalizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, për mosrealizim të të ardhurave dhe për planifikim të investimeve pa hartuar më parë projektet përkatëse.

Nga auditimi, u konstatua se në hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit nuk është specifikuar ndarja dhe mënyra e financimit, se sa përqind e vlerës do të mbulohet me fondet e veta, sa nga buxheti i shtetit dhe sa me fonde të tjera.

3. Nga auditimi i subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se: 15 subjekte kanë kryer pagesë të plotë të detyrimit deri në datën 31.12.2022 në vlerën totale 14,400,000 lekë; 2 subjekte, “E.G.” dhe K.S.”, e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 2 vendndodhje të ndryshme (kanë 2 pika shitje karburanti) dhe kanë bërë pagesë të pjesshme të detyrimit deri në datën 31.12.2023, në vlerën totale 550,000 lekë për një prej pikave, nëpërmjet Akt Marrëveshjeve të lidhura me Bashkinë Gjirokastrë; “K.S.”, Shtepëz në vitin 2020 ka nisur aktivitetin e tij në territorin dhe mjetet e instaluar teknike të aktivitetit që ka patur subjekti “F.2.”;

- për subjektet “F.2.”, Shtepëz dhe “E.G.”, Ura e lumit, nga ana e DAPPLL nuk ka informacion mbi detyrimin referuar lejes së përfutur, pasi i përkasin periudhës 2015-2020 dhe 2018-2023 në të cilën përfshihen edhe ndryshimet ligjore mbi procedurat e pajisjes me leje subjekteve që tregëtojnë karburante dhe hidrokarbure dhe të lëvizjes së shpeshtë të personelit brenda strukturës së Drejtorisë gjatë kësaj periudhe;

- subjekti “A.N.” nuk ka paguar dhe nuk e njeh detyrimin prej 1,000,000 lekë;

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga DAPPLL rezulton se vetëm për 3 subjekte “E.G.”, “K.S.” Shtepëz dhe “A.N.” detyrimi në vlerën totale është 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë; ndërsa për 2 subjektet “E.G.” dhe “F.2.” nuk ka informacion mbi detyrimin e tyre ndaj Bashkisë Gjirokastrë.

4. Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë 182,468,723 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitorë e krijuar gjatë vitit 2023 ka qenë 60,042,603 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2023, janë 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, nga e cila janë kontabilizuar vetëm 15,931,835 lekë dhe vlera **166,587,228 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

Grupi i auditimit ka vlerësuar se detyrimi (progresiv) deri në datën 31.12.2023 për disa nga taksat dhe tarifatat vendore kryesore përbëhet si më poshtë:

- Detyrime nga abonentët familjarë, në vlerën 91,715,152 lekë për 11794 debitorë;
- Detyrime nga kategoria biznes, në vlerën 66,440,562 lekë për 965 debitorë;
- Detyrime nga taksa e tokës bujqësore, në vlerën 19,362,272 lekë për 6922 debitorë;
- Detyrime nga TNI, në vlerën 1,903,345 lekë për 85 debitorë;

- Detyrime mbi dhënien me qira të tokave bujqësore, në vlerën 1,097,732 lekë për 45 debitorë;

- Debitorë problematikë (92), në shumën progresive 23,104,873 lekë.

(vlera e debitorëve problematikë është përfshirë në secilën vlerë debitore për taksa të ndryshme)

Në Bashkinë Gjirokastër nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

5. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gjirokastër informacionin tatimor e përpunon në programin EXCEL. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor për të ardhurat vendore, sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.;

Bashkia Gjirokastër nuk ka pasur bashkëpunim me ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër për të marrë informacion mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër me vlerën e përlllogaritur. Deri në datën 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastër për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE;

Bashkia Gjirokastër nuk ka regjistruar në paketën fiskale të saj si burim të ardhurash, “rentën minerare” dhe në mungesë të informacionit, DAPPLL nuk ka bërë as akt rakordimet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në moszbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 7 datë 014.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; (referuar edhe “Miratimi i vlerave referuese” nga Ministria e Financave nr. 16365 prot., datë 17.10.2012 dhe Vendimi i Komisionit AD-HOC për rentën minerare).

Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë, mbajtjen e aktrakordimeve me ta dhe krijimin e një databaze me të dhënat përkatëse nga agjentët;

Nga analiza e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023, rezultoi si më poshtë:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 4,000 mijë lekë dhe është mundur të vilet 4,464 mijë lekë ose 112% e vlerës së planifikimit, me një rënie prej 246 mijë lekë më pak se në vitin 2022;

- Taksa e rentës minerare, nuk është parashikuar për dy vite radhazi 2022 dhe 2023, dhe rezulton se nuk është vjelë për asnjë vit. DAPPLL nuk e ka ndjekur arkëtimin e saj nga subjektet duke mos bërë rakordimet me Drejtorinë e Doganës dhe Drejtorinë e Tatimeve.

- Taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 724 mijë lekë dhe realizuar në shumën 477 mijë lekë ose në masën 66%. Duhet theksuar se për vitin paraardhës 2022 vlera e arkëtimeve nga kjo taksë për llogari të Bashkisë Gjirokastër ka qenë më e lartë në shumën 3,489 mijë lekë;

- Leje shfrytëzim karburanti është parashikuar në shumën 2,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 650 mijë lekë ose në masën 33%, por rezulton se krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rënie në shumën 350 mijë lekë;

- Qira tregu Agro ushqimor është parashikuar 2,292 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,603 mijë lekë ose në masën 70%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 889 mijë lekë;

- Qira tokë bujqësore është parashikuar 757 mijë lekë dhe realizuar në shumën 545 mijë lekë ose në masën 72%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje prej 148 mijë lekë më shumë.

Mos realizimi i të ardhurave ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave periodike dhe vjetore mbi mosrealizimin tyre, mosraportimit nga ana e strukturave përgjegjëse të planifikimit vjetor e çdo takse/tarife përkatëse për hartimin e paketës fiskale të vitit pasardhës, mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes strukturave përgjegjëse që sigurojnë të ardhura duke mos u administruar në kohë informacioni tatimor nga ana e DAPPLL.

Nga Titullari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka asnjë analizë të situatës së tre subjekteve që janë pajisur me leje për tregëtim karburanti dhe hidrokarbure: “A.N.”, “F.2.” dhe “E.G.”, Ura e Lumit, për marrjen e masave me qëllim zgjidhjen shteruese të ngërçit të krijuar nga mospagesat e kryera prej tyre, dhe për subjektin “K.S.”, Shtëpëz, i cili ushtron aktivitetin e vet te territori i braktisur nga subjekti “F.2.” për të cilin nga auditimi dhe komunikimi me DAPPLL, rezultojnë informacion jo i plotë dokumentar mbi praktikën e dhënies së lejes për ushtrimin e aktivitetit për periudhën nga 2020 e në vijim

Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

6. Nga verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se janë pajisur me certifikata pronësie 10 aktive/pasuri, të llojeve kullotë, pyll, truall dhe ndërtesë, për të cilat u konstatua se pavarësisht regjistrimit në AShK, nuk është bërë vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

Nga auditimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota dhe plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, nuk janë të analizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Gjithashtu, nga Bashkia Gjirokastrë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë Aktiveve Afatgjata Materiale të transferuara në pronësi apo në përdorim ish komunave të konsoliduara aktualisht në Bashkinë Gjirokastrë.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM

7. Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Gjirokastrë, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njësisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njësisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastrë”, i janë miratuar listat e inventarit të Pasurive Publike, ndërsa Njësisë Administrative Lunxhëri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njësisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njësisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njësisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar pronat publike në pronësi dhe përdorim.

Për pronat e transferuara si më sipër, nga Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk është bërë regjistrimi në AShK, nuk janë inventarizuar, nuk janë vlerësuar, nuk janë kontabilizuar dhe nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk

ekzistojnë.

Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

8. Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- Kryetari i Bashkisë Gjirokastër ka miratuar Planin e veprimeve “*Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit*”, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 në Bashkinë Gjirokastër. “*Plani i veprimtë është dërguar*” në KLSH me shkresën nr. 11761/1 prot., datë 21.12.2023 *në tejkalim të afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin e strukturave të ngarkuara me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në mospërputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Bashkia Gjirokastër **ka kthyer përgjigje** zyrtare në KLSH *në tejkalim të afatit 20 ditor* (pas 10 javësh) nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërbllim dëmi.

- Bashkia Gjirokastër i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre. Sipas Ligjit nr.154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA. Nga auditim rezultoi se ky raportim **nuk është bërë**.

- Bashkia Gjirokastër **nuk ka raportuar** në Këshillin Bashkiak lidhur me “*Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së*”.

a. Masa Organizative janë lënë **28** Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohen **17** masa: **13** pjesërisht të zbatuara dhe **4** të pazbatuara;

b. Masa shpërbllim dëmi janë lënë **6** rekomandime në vlerën 29,655,464 lekë dhe rikërkohen në vlerën e plotë si të zbatuara pjesërisht **4** masa në vlerën totale 28,233,368 lekë dhe **2** masa të pazbatuara në vlerën 1,422,096 lekë ;

c. Masa me efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **10** masa (6 masa të rikërkua) nga të cilat rikërkohen **2** masa të pazbatuara dhe **2** masa zbatuar pjesërisht;

d. Masa për ulje të borxhit/të ardhura të munguara është lënë **1** masë në vlerën 181,012,983 lekë, e cila është në proces zbatimi.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1. Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2. Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Liçencave, të analizojnë situatën specifike të subjekteve “E.G.”, “K.S.” Shtepëz dhe “A.N.” dhe të marrin masa për arkëtimin e vlerës 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër.

Për subjektet “F.2.”, Shtepëz dhe “E.G.”, Ura e lumit, të saktësojnë vlerën e detyrimit dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të njohur dhe paguar prej tyre vlerën e plotë të detyrimit për llogari të Bashkisë Gjirokastrë.

3. Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës progresive 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, veçanërisht ndaj nëntëdhjetë e dy (92) debitorëve problematikë për arkëtimin e shumës progresive 23,104,873 lekë.

4. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

5. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

6. Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike në Bashkinë Gjirokastrë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, në mënyrë që të realizohen të gjitha procedurat e prokurimit për punë publike në shërbim të komunitetit, të marrin masa që në asnjë rast të mos parashikohen prokurime për punë publike pa pasur paraprakisht të disponueshëm projektin përkatës, me të gjitha detajet sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës.

7. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukurore, për mirëadministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit;

8. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave të marrin masa për:

- Planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;

- Të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimorë sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Gjirokastrë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimorë nuk realizojnë dhe pasqyrojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Gjirokastrë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

- Të bëjnë pjesë të Paketës Fiskale “të ardhurat nga renta minerare”, si e ardhur në buxhetin e bashkisë nga aktiviteti që ushtrohet në territorin e saj për shfrytëzimin e mineraleve.

- Të caktojë në strukturën e DAPPLL një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

9. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat

për vlerësimin dhe regjistrimin në kontabilitet të të gjitha Aktiveve Afatgjata Materiale, përfshirë asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Vlerësimi i aseteve të bëhet për vlerën reale, sipas zonave kadastrale dhe të regjistronen si pasuri e saj në AShK, dega Gjirokastër.

10. Drejtoria Ekonomike të marrë masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve të Bashkisë me të gjitha kërkesat e formatit të miratuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirëmenaxhimit të tyre.

Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM

11. Bashkia Gjirokastër, të marrë masa që për Njësitë Administrative për të cilat është miratuar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, me qëllim përfundimin e procedurës së transferimit, si dhe për pronat të cilat janë transferuar, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastër dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve, etj., me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

12. Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara.

1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Gjirokastër për vitin ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj, duke konkluduar në një **Opinion të modifikuar, me theksim çështjeje.**

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705 [2], dhe ISSAI 1200 [3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*”. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.

Baza për opinionin e modifikuar, me theksim çështjeje:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara

gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë anomalitë e mëposhtme:

1. Materialiteti për shpenzimet është vlerësuar 20,968,969 lekë, ndërsa për të ardhurat është vlerësuar 23,496,071 lekë.

2. Nga verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se janë pajisur me certifikata pronësie 10 aktive/pasuri, të llojeve kullotë, pyll, truall dhe ndërtesë, për të cilat nuk është bërë vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

3. Për pronat e transferuara me VKM, nga Bashkia Gjirokastër, nuk është bërë regjistrimi në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk janë vlerësuar, nuk janë kontabilizuar dhe nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

4. Deri në datën 31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë 182,468,723 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2023 ka qenë 60,042,603 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifata vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2023, janë 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, nga e cila janë kontabilizuar 15,931,835 lekë dhe vlera prej **166,587,228 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër.

5. Në datën 31.12.2023, vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit është 3,053,135 lekë, janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për vlerën 1,182,000 lekë** (detyrime për shpenzime kapitale në vlerën 219,000 lekë dhe detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 962,962 lekë). Nga auditimi, rezultoi se krahasuar me vlerën totale të buxhetit të vitit 2023, e cila është 1,156,416 mijë lekë të shpenzuara, Bashkia Gjirokastër nuk është në gjendjen e vështirësisë financiare.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 621/1, datë 09.05.2024 “Auditim Financiar në Bashkinë Gjirokastër”, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Gjirokastër”, nga data 13.05.2024 deri në datën 07.06.2024, u krye “Auditimi Financiar”, për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., Përgjegjës Grupi;
2. F.Ç.;
3. S.J., anëtarë.

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për

përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Gjirokastrë.

Identifikimi i çështjes: Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Gjirokastrë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë Gjirokastrë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Kryetari i Bashkisë, z. F.G., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. A.K., Drejtor i Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si ligji organik i buxhetit apo legjisllacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e

kaluara;

- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Gjirokastrë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhëri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhëri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që kanë ndryshuar këtë ligj; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr.

248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shitesave të tjera mbi pagë të ZËVENDESMINISTRIT, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit: Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹: Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e

¹ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i

zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

Kontrolli aritmetik: Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese: Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese: Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

Kontrolli i vlerësimeve: Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

Konfirmimi nga të tretët: Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Kontrolli sipas një treguesi: Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

Verifikimi i transaksioneve: Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

Intervistimi: Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

Raporte dhe informacione: Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm: Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve dhe Akt Verifikimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim për Akt Konstatimet, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 621/5, datë 27.05.2024. Nga ana e Bashkisë Gjirokastrë me shkresën nr. 2991/1, datë 28.06.2024, protokolluar në KLSH me nr. 188/6, datë 02.07.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së Projekt Raportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim, nga audituesit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Gjirokastrë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 25,301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil ajo numëron 52,054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km², me një densitet prej 53.91 banorë/km² sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrit Civil.

Të dhëna të tjera: Bashkia e re e Gjirokastrës përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti te prodhimet blegtorale.

Gjirokastra është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi. Katet përdhese të shtëpive karakteristike shërbenin si struktura mbrojtëse edhe depo të shtëpive.

Kostumet lokale të Gjirokastrës janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar. Po ashtu prodhohen në mënyrë artizanale qilima e velenxa, triko, çorape e doreza. Të famshme në të gjithë vendin janë dantellat e Gjirokastrës; punime me grep dhe qëndisimat. Ndërsa burrat përpunojnë drurin dhe gurin. Veshjet tradicionale popullore të grave zbukuroheshin me fije metalesh të çmuara si kostumet e famshme të grave të Lunxhërisë. E integruar në Iso-polifoninë shqiptare, ajo është njohur më 2005 nga UNESCO si “trashëgimi kulturore e paprekshme”.²



² Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-gjirokastrer/pasaporta-e-bashkise-gjirokastrer/>

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:

| Emri i Njësitë | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre |
|-----------------------|--|
| Gjirokastrë | Qyteti Gjirokastrë |
| Cepo | Fshatrat; Fushëbardhë, Zhulat, Taroninë, Mashkullorë, Palokastër, Çepun, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji, Humelicë |
| Lazarat | Fshatrat; Lazarat, Kordhocë |
| Picar | Fshatrat; Picar, Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel |
| Lunxhëri | Fshatrat; Qesorat, Dhoksat, Këllëz, Mingul, Nokovë, Erind, Gjat, Kakoz, Karjan, Valare |
| Odrie | Fshatrat; Andon Poçi, Hundëkuq, Tërbuq, Labovë e Madhe, Labovë e Vogël |
| Antigonë | Fshatrat; Asim Zeneli, Arshi Lengo, Krinë, Tranoshisht, Saraqinisht |

Forma dhe mënyra e organizimit:

Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 98, datë 11.12.2023, “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë”, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1219/1 prot., datë 20.12.2022, i ndryshuar me VKB nr. 64, datë 31.07.2023 dhe urdhërit nr. 945, datë 07.12.2022 me nr. 13471 prot., datë 07.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë dhe Njësitë Administrative për vitin 2023”. Numri i punonjësve është miratuar me urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. 2, datë 04.01.2023

Kuadri ligjor:

Bashkia Gjirokastrë është e organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Gjirokastrë, akte të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Gjirokastrë dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë është z. F.G. dhe Këshilli Bashkiak i Gjirokastrës përbëhet nga 31 anëtarë, të cilët janë mandatuar në zgjedhjet e datës 28 qershor 2023.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori, si dhe në nivel institucioni dhe në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.

Mbi mjedisin e kontrollit:

Bashkia Gjirokastër funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, miratuar me Vendimin nr. 65, datë 07.07.2022, “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Gjirokastër”, e ndryshuar me Vendimin nr. 16, datë 16.03.2023. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjisllacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.

Me Urdhërin nr. 169, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2022-2023 i përbërë nga 14 punonjës, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

Nga Bashkia Gjirokastër nuk disponohet Kodi i Etikës por në nenin 20 “Etika për punonjësit e Bashkisë Gjirokastër dhe Kodi i Veshjes” të Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 65, datë 07.07.2023, i ndryshuar, të Kryetarit të Bashkisë janë të përfshirë rregulla të etikës në të cilat përcaktohen edhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

Për vitin 2023, në Bashkinë Gjirokastër, referuar strukturës së detajuar për vitin 2023, sipas Urdhërit nr. 945, datë 07.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2023”, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në aparatit e Bashkisë Gjirokastër, të agjencive dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë, ka qenë 621 punonjës.

Menaxhimi i riskut:

Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, rezultoi se:

Regjistri i riskut për vitin 2023, në Bashkinë Gjirokastër është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, referuar shkresës nr. 12237 prot., datë 27.12.2023. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për vitin 2023, duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut.

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatori i Riskut është kompetencë e cila është deleguar nga Kryetari i Bashkisë për vitin 2022 sipas Urdhërit nr. 169, datë 11.03.2022, znj. E.L..

Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 21, pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pika 2.5.2, “Menaxhimi i riskut”.

Veprimtaritë e kontrollit:

Në zbatim të kërkesave të nenit 22 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, rezultoi se:

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga Nëpunësi Autorizues, z. F.G. me detyrë Kryetar i Bashkisë dhe Nëpunësi Zbatues, znj. A.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e

Thesarit Gjirokastër sipas shkresës nr. 14794/1 prot., datë 15.08.2019, dhe rikonfirmuar me email-in e datës 05.08.2019 dhe shkresën nr. 4908/1 prot., datë 12.04.2017.

Për periudhën objekt auditimi Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, "*Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*", pika 3.2 "*Cikli i menaxhimit financiar dhe kontrollit*", hapi 5.

Bashkia Gjirokastër nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 17, pika 1.

Bashkia Gjirokastër nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 4, pika 20.

Informacioni dhe komunikimi:

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Gjirokastër dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Monitorimi:

Me shkresën nr. 2029 prot., datë 28.02.2023, nga Bashkia Gjirokastër është hartuar dhe dërguar në MFE Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, "*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike*", pika 15.

Me shkresën nr. 1626/2 prot., datë 29.02.2024, Bashkia Gjirokastër ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 "*Pyetësori i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit*".

Nuk ka raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti kjo situatë është konstatuar kryesisht në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, ku nga kjo drejtori nuk janë paraqitur raporte pranë Titullarit të institucionit dhe Drejtorisë së Financës mbi situatën debitore në lidhje me taksat dhe tarifat vendore.

Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*", pika 2.2, dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Bashkia Gjirokastër ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Për vitin 2023, NjAB është miratuar me Urdhërin nr. 945, datë 07.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2023”. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Gjirokastër, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Gjirokastër për vitin 2023 ka funksionuar me 1 Përgjegjës dhe 2 Specialistë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër. Për vitin 2023, Përgjegjës i NjAB ka qenë z. K.T., me arsim të lartë, me eksperiencë 3 vjeçare në auditim, aktualisht i larguar. Specialistë kanë qenë, znj. A.K. e cila ka marrë certifikatën e audituesit të brendshëm, me eksperiencë 6 vjeçare në auditim, aktualisht e larguar dhe z. B.I., në proces certifikimi si auditues i brendshëm.

Në Bashkinë Gjirokastër vihet re se janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale nga të tre punonjësit.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2022 është miratuar me shkresën 112/1 prot., datë 12.02.2022, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitet 2023-2025 me shkresën nr. 11253 prot., datë 17.10.2022, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar shkresës nr. 5309 prot., datë 06.06.2023 “Për një ndryshim në planin e auditimit të brendshëm në Bashkinë Gjirokastër”, për vitin 2023, synohen të realizohen 9 auditime.

3. Raportimi vjetor për vitin 2023, është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1057/1 prot., datë 14.02.2024, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe e Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2023 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, në të është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

Të dhënat e detajuara janë paraqitur në Aneksin AB1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

Duke u bazuar në planin vjetor për vitin 2022 për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB, i cili është miratuar me shkresën nr. 10983 prot., datë 30.09.2021, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

1. Auditimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Arkivës dhe Protokollit;
2. Auditimi në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore;
3. Auditimi në Drejtorinë e Financës;

4. Auditimi në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave dhe Licencave (Auditim tematik në lidhje me pronat);
5. Auditim në Gjendjen Civile;
6. Auditim në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike (Auditim tematik në lidhje me prokurimet);
7. Auditim i detyrimeve të prapambetur në Drejtorinë e Financës;
8. Auditim në Drejtorinë e Arsimit;
9. Zbatim i rekomandimeve.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, seksioni VI, kreu III, pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2022, janë planifikuar për t'u kryer 9 auditime, nga të cilat deri më datën 31.12.2022, kanë përfunduar 7 auditime ose 77% dhe janë në proces realizimi 2 auditime.

Rekomandimet e dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022, si dhe faza e zbatueshmërisë së tyre është paraqitur në Aneksin AB2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura, u konstatua se në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, si më poshtë:

- Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Hapi 11, "*Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar*".

- Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, "*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi, referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

- Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast, si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit, janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik, me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr. 260, datë 22.04.2022, të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve, të miratuar përkatësisht me VKB nr. 21, datë 31.03.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 3622, datë 09.04.2021 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 5886, datë 31.05.2022.

Projekt buxheti për vitin 2023-2025 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Ligjit nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 5886, datë 31.05.2022 me relacionin shpjegues për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2023-2025 me shkresën nr. 9906, datë 15.09.2022.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2023-2025, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 8 programe buxhetore.

Gjatë hartimit të PBA për vitet 2023-2025, është përcaktuar “Përshkrimi” i çdo programi, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu, çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve, sipas PBA (shpërndarja e fondeve sipas programeve), është paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tendenca e të ardhurave sipas PBA 2023-2025, është paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me VKB nr. 100, datë 16.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1238/1 prot., datë 29.12.2022.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Gjirokastrë, për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë planifikuar për t’u përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 483,954 mijë lekë (Të ardhura të vitit në shumën 230,477 mijë lekë dhe granti 253,364 mijë lekë) ose në masën 68.5% nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale në shumën 222,149 mijë lekë ose në masën 31.5%.

Për sa i përket shpenzimeve, nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 shpenzimet për paga e sigurime zënë 65% ose në vlerën 462,249 mijë lekë, shpenzimet korrente zënë 22.6% ose për vlerën 159,960 mijë lekë dhe shpenzimet për investime zënë 12% ose në vlerën 83,781 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhërin nr. 945, datë 07.12.2022. Numri maksimal i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 98, datë 16.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1219/1 prot., datë 20.12.2022, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. 2, datë 04.01.2023, sipas Aneksit B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 98, datë 16.12.2022, në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, VKM nr.

627, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike””, VKM nr. 604, datë 14.09.2022 “Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM nr. 465, datë 06.07.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.03.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar””, i ndryshuar, VKM nr. 624, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 350, datë 19.4.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””, VKM nr. 625, datë 28.9.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të këshillit të ministrave, “Për grupimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisë të vetëqeverisjes vendore””, të ndryshuar, Projektit “Ofrimi i Shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastrë”, Aplikimit nr. 3392/1 prot., datë 20.05.2019 për Fondin Social, Njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5144 prot., datë 29.10.2019, Urdhërit nr. 139, datë 28.04.2022 “Për mbylljen fizike të shërbimeve pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore dhe Bashkimit të Dhomave të Tregëtisë dhe Industrisë dhe dhomave të tregëtisë”, etj.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli, është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastrë dhe janë raportuar periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli, sipas shërbimeve.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare dhe ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Për vitin 2023, buxheti shtesë gjithsej është në vlerën 729,653 mijë lekë, e analizuar si më poshtë:

1. Fonde të kushtëzuara për ndihmën ekonomike, në vlerën 197,802 mijë lekë;
2. Fonde të kushtëzuara për Gjendjen Civile, në vlerën 7,727 mijë lekë;
3. Fonde të kushtëzuara për Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vlerën 65 mijë lekë;
4. Fonde të kushtëzuara për emergjencat civile, në vlerën 5,975 mijë lekë;
5. Fonde të kushtëzuara për shpërblimin e zjarrfikësve, në vlerën 1,655 mijë lekë;
6. Fonde të kushtëzuara për subvecionimin e qerave të banesave, në vlerën 2,290 mijë lekë;
7. Fonde të kushtëzuara për investimin “Përmirësimi i kushteve të banimit”, në vlerën 16,280 mijë lekë;
8. Fonde të kushtëzuara për investimin “Rikonstruksioni i palestrës së shkollës “Asim Zeneli” dhe shkolla “Drita””, në vlerën 49,859 mijë lekë;
9. Fonde të kushtëzuara për trajtimin e bursave, në vlerën 1,072 mijë lekë;
10. Fonde të kushtëzuara nga KQZ, në vlerën 2,597 mijë lekë;
11. Fonde të përfituara nga rimbursimi i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës së projekteve IPA, në vlerën 420 mijë lekë;
12. Fonde të kushtëzuara për investimin “Ujësjiellësi Lazarat”, në vlerën 99,400 mijë lekë;
13. Fonde të trashëguara nga viti 2022, në vlerën 265,506 mijë lekë;

14. Fonde të kushtëzuara për realizimin e projektit “*Rikonstruksioni i kinemasë multifunktionale “Try Gjirokastra”*”, në vlerën 9,000 lekë;
15. Fonde të kushtëzuara për realizimin e objektit “*Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Cfaqës, pranë rr. Nacionale Gjirokastër-Kakavijë, loti 2*”, në vlerën 24,528 mijë lekë;
16. Fonde të grantit të pakushtëzuar për efektin rritës të pagave, në vlerën 9,186 mijë lekë;
17. Fonde të grantit specifik për efektin rritës të pagave, në vlerën 7,830 mijë lekë;
18. Fonde nga donatorët për implementimin e projektit “*Askush të mos mbetet pas*”, në vlerën 2,998 mijë lekë;
19. Fonde nga donator për implementimin e projektit “*Romacted*” në vlerën 1,598 mijë lekë.
20. Fonde nga donator për implementimin e projektit “*Konstruksioni i tregut lokal roma Gjirokaster Roma on Market*” në vlerën 23,866 mijë lekë.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar, janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar aktrakordimeve me thesarin është paraqitur në Aneksin B6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përdorimi i të ardhurave për vitin 2023, është paraqitur në Aneksin B7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2023, nga 1,435,644 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,156,416 mijë lekë ose në masën 80.5%, (Pagat (600) nga 437,194 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 399,612 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhurat e veta 76,751 mijë lekë, granti 109,594 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar 204,189 mijë lekë, të deleguara 5,408 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar 3,670 mijë lekë) ose 91%, sigurimet shoqërore (601) nga 68,925 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 65,896 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhura e veta 10,832 mijë lekë, granti 18,488 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar 35,712 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar 864 mijë lekë) ose 96%, Shpenzimet operative (602) nga 183,374 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 151,486 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhura e veta 64,351 mijë lekë, granti 26,459 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar 60,254 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara 136 mijë lekë dhe të kushtëzuara 286 mijë lekë) ose 83% dhe shpenzimet për investime (230-231) nga 511,337 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 317,503 mijë lekë, (me burim të ardhurash: të ardhurat e veta 91,134 mijë lekë, granti 73,322 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar specifikë 4,211 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar 148,836 mijë lekë) ose 63%.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2023, janë dërguar MFE me shkresën nr. 5151, datë 31.05.2023 “*Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë*”, shkresën nr. 9288, datë 29.09.2023 “*Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin e vitit 2023*” dhe shkresën nr. 1627,

datë 29.02.2024 “Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2023”, brenda afateve ligjore.

2.2.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre.

Nga auditimi, u konstatua se në hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit nuk është specifikuar ndarja dhe mënyra e financimit, se sa përqind e vlerës do të mbulohet me fondet e veta, sa nga buxheti i shtetit dhe sa me fonde të tjera.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 3, pika 2.

Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2023, është paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2023, është paraqitur në Aneksin B9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se nuk janë realizuar 3 procedura prokurimi për punë publike, pasi sipas Drejtorisë së Prokurimeve “mungon projekti”. Në mungesën e një projekti këto procedura nuk duhet të ishin planifikuar fare si investime, por të ishin planifikuar procedura të tjera, për objekte apo punë të tjera publike për të cilat disponohej një projekt dhe mund të realizoheshin.

Procedurat e prokurimit të porealizuara janë paraqitur në Aneksin B10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar edhe të dhënave të MFE, rubrika “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në Aneksin B11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Raportet mbi detyrimet për vitin 2023, janë dërguar MFE me shkresën nr. 5151, datë 31.05.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë”, shkresën nr. 9288, datë 29.09.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin e vitit 2023” dhe shkresën nr. 1627, datë 29.02.2024 “Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2023”, brenda afateve ligjore.

Totali i detyrimeve sipas bilancit është për vlerën 3,053,135 lekë, janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për vlerën 1,182,000 lekë** (detyrime për shpenzime kapitale në vlerën 219,000 lekë dhe detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 962,962 lekë). Diferenca për vlerën 1,870,900 lekë që nuk është raportuar MFE, ka të bëjë me paradhëniet për kopshte e çerdhe në fund të vitit. Detyrime të papaguara në datën 31.12.2023, janë në vlerën totale 1,182,000 lekë (detyrime për investime në vlerën 219,000 lekë dhe detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 962,962 lekë).

Sa më sipër, rezultoi se Bashkia Gjirokastrë nuk është në gjendjen e vështirësisë financiare.

Nga të dhënat e bilancit, rezultoi se detyrimi i faturave të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore në fund të vitit 2022, që i përkasin llogarisë (467) “Kreditorë të ndryshëm”, janë për vlerën gjithsej 219,273 lekë sipas të dhënave të paraqitura në Aneksin B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në mënyrë analitike, detyrimet për vendimet gjyqësore janë paraqitur në Aneksin B13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Gjirokastrë ka detyrime për kontrata të cilat janë mbuluar me fonde të Ministrisë (AKUM) në vlerën 219,273 lekë për objektin Mbikëqyrje për objektin “Ujësjetësi Lazarat”.

Pagesat për blerje mallra e shërbime llogaria 602 “Shpenzime operative”, në vitin 2023, që i përkasin vitit 2022, janë paraqitur në Aneksin B14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pagesat për blerje mallra e shërbime llogaria 602 “Shpenzime operative”, që i përkasin vitit 2023, janë paraqitur në Aneksin B15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shpenzimet për investime (230-231):

Pagesat për investimet llogaria 230-231 “Shpenzime për investime”, për kontrata të vitit 2023 janë paraqitur në Aneksin B16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Për vitin 2023, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 98, datë 11.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë”, i ndryshuar me atë nr. 64 datë 31.07.2023 dhe Urdhërit nr. 945 datë 07.12.2022 me nr. 13471 prot., datë 07.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë dhe Njësive Administrative për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave, e cila sipas strukturës së vitit 2023 përbëhet nga 4 sektorë dhe në total ka 25 punonjës; Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave publike, Lejeve dhe Licencave përbëhet: Drejtori, Sektori i kontabilizimit dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve, Sektori i lejeve licencave dhe administrimit të pronave publike, Sektori i menaxhimit të ndërmarrjeve dhe tregjeve publike dhe Inspektoriatit i kontrollit në terren.

Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave për vitin 2023 është paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Drejtoria e të Ardhurave në analizat periodike që zhvillon mbi aktivitetin e drejtorisë në vjeljen e taksave e tarifave apo pagesat e detyrimeve të prapambetura, për çdo raportim të transmetuar nga personat përgjegjës, harton dhe një plan masash periodike për përmirësimin e punës në arritjen e objektivave. Në fillim të çdo viti, DAV bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të Bashkisë, i cili është pjesë e Raportit vjetor të monitorimit dhe Raportit të buxhetit që prezantohet për miratim në Këshillin Bashkiak. Specialistët bëjnë verifikime në terren për pajisjen e subjekteve me tabela, për ndryshime të objekteve ku ushtrohet biznesi etj. Informacioni i mbledhur përpunohet nga specialistët, të cilët mbështetur te paketa fiskale e vitit ushtrimor, në rast ndryshimesh bëjnë rilogallitjen e taksave dhe tarifave për çdo biznes. Pagesa e taksave është vjetore dhe referuar paketës fiskale të miratuar, për biznesin e madh afati fundor është data 30 prill i vitit pasardhës dhe për biznesin e vogël/familjarët afati fundor është 30 qershor i vitit pasardhës. Paketa fiskale e miratuar nga KB me Vendimin nr. 92 datë 24.11.2022 dhe me nr. 1970 prot., datë 24.11.2022, përmban taksa e tarifave vendore të klasifikuara për territorin e brendshëm të bashkisë (qytetin) dhe për rrethinat dhe NJA (fshatrat).

Paketa fiskale për vitin 2023 është paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku u konstatua se:

- Për NjA Gjirokastrë (qyteti) janë miratuar me VKB 6 grup taksash dhe 24 grup tarifash; për 6 NjA (fshatrat) janë miratuar me VKB 8 grup taksash dhe 23 grup tarifash;

- Afati fundor i pagesës së taksave dhe tarifave të vitit ushtrimor për biznesin e madh është data 30 prill i vitit pasardhës dhe për biznesin e vogël dhe familjarët është data 30 qershor i vitit pasardhës.

- Në paketën fiskale të miratuar në Këshillin Bashkiak, nuk janë listuar si burim të ardhurash nga bankomatet e atyre Degëve bankare të cilat janë regjistruar si Subjekte (me adresë dytësore) dhe që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Gjirokastër.

- DAV Bashkia Gjirokastër informacionin tatimor e përpunon në programin *EXCEL*. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, rregjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

- DAV verifikon dhe përditëson dokumentacionin e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2023, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 63, datë 24.11.2022, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1164/1 prot., datë 09.12.2022. Nga të dhënat e paraqitura në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, rezulton se për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në vlerën 76,495 mijë lekë ose masën 98%; ndërsa për vitin 2023 janë realizuar vlerën 82,445 mijë lekë ose në masën 102%. Pra nga viti 2022 në vitin 2023 ka patur një rritje të të ardhurave në vlerën 5,950 mijë lekë.

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, me ndryshimet në kuadrin ligjor tatimor nuk planifikohet, por rezulton se për vitin 2022 janë arkëtuar 158 mijë lekë dhe për vitin 2023 janë arkëtuar 239 mijë lekë, të cilat janë detyrime të prapambetura.

- Për Taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, referuar paketës fiskale, rezulton se për dy vitet e njëpasnjëshme 2022-2023 është parashikuar një vlerë e përafërt prej 724 mijë lekë dhe janë arkëtuar 3,966 mijë lekë për vitin 2022 dhe 477 mijë lekë për vitin 2023. DAV nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastër, por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër;

- Nga ana e DAV na u komunikua se UK Gjirokastër ka rolin e agjentit tatimor, për vjeljen e taksave familjare.

Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023:

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin A3, rezultoi:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 4,000 mijë lekë dhe është mundur të vilet 4,464 mijë lekë ose 112% e vlerës së planifikimit, me një rënie prej 246 mijë lekë më pak se në vitin 2022;

- Taksa e ndërtesës është parashikuar në shumën 3,9405 mijë lekë dhe është vjelë 32,570 mijë lekë ose në masën 83% të tij, por vlera e saj ka ardhur në rritje prej 1,406 mijë lekë më shumë se në vitin 2022;

- Taksa e rentës minerare, nuk është parashikuar për dy vite radhazi 2022 dhe 2023, dhe rezulton se nuk është vjelë për asnjë vit. DAV nuk e ka ndjekur arkëtimin e saj nga subjektet duke mos bërë rakordimet me Drejtorinë e Doganës dhe Drejtorinë e Tatimeve.

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 724 mijë lekë dhe realizuar në shumën 477 mijë lekë ose në masën 66%. Duhet theksuar se për vitin paraardhës 2022 vlera e arkëtimeve nga kjo taksë për llogari të Bashkisë Gjirokastër ka qenë më e lartë në shumën 3,489 mijë lekë;

- Leje tregëtim karburanti është parashikuar në shumën 2,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 650 mijë lekë ose në masën 33%, por rezulton se krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rënie në shumën 350 mijë lekë;

Qira tregu Agro ushqimor është parashikuar 2,292 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,603 mijë lekë ose në masën 70%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 889 mijë lekë;

Qira tokë bujqësore është parashikuar 757 mijë lekë dhe realizuar në shumën 545 mijë lekë ose në masën 72%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje prej 148 mijë lekë më shumë.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Në Rregulloren e brendshme të institucionit, në strukturën e DAV nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agentët:

- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRRGjirokastër”, për llogari të Bashkisë Gjirokastër. Akt rakordimi përcillet nëpërmjet emailit zyrtar nga DRSHTRR.

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Gjirokastër”.

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor ASHK Vendore Gjirokastër. Deri tani, ASHK Vendore Gjirokastër nuk ka patur bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër me vlerën e përllorarit. Deri në datën 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastër, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer;

- Grupi i auditimit ka verifikuar nga regjistri i lejeve minerare aktive të AKBN-së³ (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore), dy subjekte të regjistruar për aktivitete shfrytëzimi të vendburimeve minerare brenda territorit të Bashkisë Gjirokastër, (sipas Aneksit A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), për të cilat Bashkia Gjirokastër duhet të vjelë rentën minerare. Bashkia Gjirokastër dhe DAV nuk ka informacion. Kjo ka sjellë që DAV nuk ka realizuar akt rakordimet mujore me Drejtorinë e Doganave dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe si rrjedhojë nuk ka as informacion nëse kalojnë apo jo në Thesar për llogari të Bashkisë Gjirokastër.

Bashkia Gjirokastër nuk ka regjistruar në paketën fiskale të saj si burim të ardhurash, “rentën minerare” dhe në mungesë të informacionit, nuk ka bërë as akt rakordimet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për pagesat e bëra nga dy subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi të vendburimeve minerare, në moszbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 7 datë 014.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; (referuar edhe “Miratimi i vlerave referuese” nga Ministria e Financave me shkresën nr. 16365 prot., datë 17.10.2012 dhe Vendimi i Komisionit AD-HOC për rentën minerare).

Detyrimet nga taksa e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore:

Bashkia Gjirokastër ka sipërfaqe toke bujqësore në pronësi të saj transferuar me VKM si më poshtë:

| Emërtimi i asetit | Sip. në ha |
|--|------------------|
| Tokë bujqësore e pandarë, e cila nuk administrohet nga Bashkia Gjirokastër | 622.00 |
| Pyje | 10,265.47 |
| Kullotë | 12,451.00 |
| Totali | 23,338.47 |

Burimi: Bashkia Gjirokastër

3 <http://www.akbn.gov.al/regjistri-i-lejeve-minerare-aktive-shkurt-2023>

Tokat bujqësore të Bashkisë Gjirokastër sipas sipërfaqeve të ndara pasqyrohen si më poshtë:

| Njësi Administrative/Institucion | Sipërfaqja në ha | |
|----------------------------------|------------------|--------------|
| | Të ndara | Të pandara |
| ATP me VKM 770/2014 | | 330.0 |
| Ish NB | | 220.0 |
| MBZHR me VKM 455/2014 | | 196.8 |
| Të tjera | | 622.2 |
| Totali | 5,412 | 1,369 |

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë, rezulton se sipërfaqja e tokës bujqësore me sipërfaqe 220 ha, nuk administrohet nga Bashkia Gjirokastër dhe si rrjedhojë nuk janë lidhur kontrata me subjekte private për t'u përdorur prej tyre.

Gjendja debitore e familjeve që disponojnë tokë bujqësore për vitin 2023 është si më poshtë:

| Nr. | Njësitë Administrative | Nr. Familjeve | Vlera progresive 31.12.2022 | Nr. Familjeve | Vlera progresive 31.12.2023 |
|---------------|------------------------|---------------|-----------------------------|---------------|-----------------------------|
| 1 | Cepo | 4,974 | 22,062,198 | 2,042 | 6,702,168 |
| 2 | Lazarat | | | 1,497 | 2,278,590 |
| 3 | Lunxheri | | | 1,461 | 3,555,742 |
| 4 | Picar | | | 671 | 4,031,207 |
| 5 | Odrie | | | 480 | 1,916,209 |
| 6 | Antigone | | | 771 | 878,356 |
| Totali | | 4,974 | 22,062,198 | 6,922 | 19,362,272 |

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Nga auditimi dhe nga analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelë, rezultoi se numri i debitorëve nga taksa e tokës bujqësore ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 1,948 debitorë dhe një vlerë debitore progressive në rënie prej 2,699,926 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i pagesave të pjeshme të bëra nga debitorët. Vlera prej 19,362,272 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

Tabela e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Gjirokastër për vitin 2023:

- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit të Ujërave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave, u konstatua se kjo drejtori nuk ka dërguar në Këshillin e Qarkut Gjirokastër, informacionin mbi treguesit kadastralë të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor. Në Bashkinë Gjirokastër ka 12,451.00 ha kullota dhe 10,265.47 ha pyje.

- Nga auditimi rezultoi se janë lidhur 169 kontrata për marrje me qira të kullotave dhe se nuk ka detyrime të paarkëtuara, sipas tabelës më poshtë.

| Numri i subjekteve | Emërtimi i kontratës/kullota | Kontrata | | Sipërfaqja në ha | Vlera në lekë | statusi |
|--------------------|------------------------------|-----------|--------------|------------------|------------------|----------|
| | | 3 vjeçare | shumëvjeçare | | | |
| 99 | Kontrata verore | 1 | 2 | 9549.59 | 3,398,600 | arkëtuar |
| 70 | Kontrata dimërore | 12 | 1 | 4436.05 | 1,520,040 | arkëtuar |
| 169 | Totali | 13 | 3 | 13985.64 | 4,918,640 | √ |

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Nga auditimi dhe analiza e informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se arkëtimi i tyre në vlerën totale prej 4,918,640 lekë, është realizuar pa u lidhur kontrata, me qëllim garantimin e vjeljes së detyrimit por edhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura nga qiradhënia.

Detyrimet e familjarëve:

Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese:

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave dhe Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore për abonentët familjarë.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në stendat e bashkisë apo Njësi Administrative.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësit e saj me

qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Gjirokastrë ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agentit tatimor.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti.

Detyrimet e biznesit dhe familjarëve për taksat dhe tarifave vendore janë paraqitur të përmbledhura në Aneksin A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se ka një rritje të numrit të debitorëve familjarë si më poshtë:

- Taksa e ndërtesës+taksa familjare+sh.varreza, nga 11,485 në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën totale progresive prej 88,088,383 lekë, është rritur në 11,794 debitorë me një vlerë totale prej 91,715,152 lekë; diferenca nga viti 2022 në vitin 2023 prej (-) 3,626,769 lekë më shumë; pavarësisht rritjes në vlerë të arkëtimeve, vlera e detyrimit ka ardhur në rritje për shkak të krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit 2023. Vlera prej 91,715,152 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2023. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, nenet 88 deri 104.

- Taksa e tokës bujqësore nga 22,062,198 lekë në mbyllje të vitit 2022 në 19,362,272 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë në rënie të debisë progresive prej 2,699,926 lekë, por rritje të numrit të debitorëve me 1,948 posedues të tokës bujqësore;

- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë në mbyllje të vitit 2022 numri i debitorëve progresive është 76 me një vlerë totale progresive prej 1,690,840 lekë; gjatë vitit 2023 janë 9 debitorë të rinj në vlerë totale 162,160 lekë; pavarësisht arkëtimeve dhe faktit të numrit të debitorëve për TNI vjen në rënie nga viti në vit, shuma totale për tu arkëtuar mbetet e lartë.

- Numri i debitorëve nga biznesi i madh dhe ai i vogël rezulton se ka ardhur në rënie nga 1,032 debitorë në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën progresive të debisë prej 70,197,984 lekë, në 965 debitorë në mbyllje të vitit 2023 me vlerë progresive të debisë prej 66,440,562 lekë. Ka një ulje të debisë nga viti 2022 në vitin 2023 prej 3,757,422 lekë; ndërsa përsa i përket krijimit të debitorëve të rinj, nga komunikimi verbal rezulton se shumica e tyre janë biznese të reja dhe kanë braktisur aktivitetin duke mos ndjekur hapat e procedurës së mbylljes së tyre në QKB, ku pagesa e taksave dhe tarifave vendore është pjesë e saj.

- Për qiratë e tokave bujqësore, ndaj bashkisë Gjirokastrë janë në total 45 familje debitorë në vlerën totale 1,097,732 lekë; rezulton se numri i tyre ka ardhur në rritje nga 17 debitorë në mbyllje të vitit 2022 në 45 debitorë në mbyllje të vitit 2023. Vlera prej 114,078,501 lekë nga debitorët familjarë dhe vlera prej 66,440,000 lekë nga debitorët e biznesit konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë;

Nga sipërfaqe e tokës bujqësore të dhëna me qira, për vitin 2023 janë planifikuar 757 mijë lekë dhe janë vjelë 545 mijë lekë ose 72% e planit, sipas pasqyrës më poshtënë mijë lekë:

| Emërtimi | Plan 2022 | Fakt 2022 | % | Plan 2023 | Fakt 2023 | % |
|------------------------|-----------|-----------|------|-----------|-----------|----|
| Qira e tokës bujqësore | 757 | 397 | 52.5 | 757 | 545 | 72 |

Taksa e tokës bujqësore:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2023 është prej 7,020 mijë lekë dhe është arritur të vilen 4,617 mijë lekë ose 66% e saj, sipas pasqyrës më poshtë në mijë lekë:

| Emërtimi | Plan 2022 | Fakt 2022 | % | Plan 2023 | Fakt 2023 | % |
|-------------------------|-----------|-----------|----|-----------|-----------|----|
| Taksa e tokës bujqësore | 6,425 | 3,190 | 50 | 7,020 | 4,617 | 66 |

Klasifikimi i tokës bujqësore sipas bonitetit dhe pritshmëria vjetore për vitin 2023 është paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë rezulton se sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore e ka NjA Lunxhëri me 1,666 ha ose 30.8% të totalit dhe atë më të vogël e ka NjA Odrie me 559 ha ose 10.3% të totalit; sipërfaqen më të madhe me bonitetin II e ka NjA Lazarat me 70 ha ose 31.1% e totalit të kësaj kategorie dhe sipërfaqen më të vogël e kanë NjA Antigone dhe NjA Odrie me 45 ha ose me 20% të totalit për këtë kategori, ndërsa NjA Picar dhe NjA Lunxhëri nuk kanë sipërfaqe me këtë kategori boniteti; sipërfaqe më të madhe ka ajo me bonitet IV prej 1,310 ha ose 24.2% të sipërfaqes totale të tokës bujqësore gjë e cila ka dhe pritshmërinë vjetore më të madhe në vlerë prej 1,768,500 lekë ose 25.1% të vlerës totale.

Nga informacioni i pasqyruar edhe në tabelat respektive rezulton se për taksën e tokës bujqësore, vlera e saj e miratuar në Këshillin Bashkiak vilet referuar klasifikimit të tokës bujqësore sipas bonitetit.

Tokat bujqësore të dhëna me qira, situata e debitorëve:

Nga DAV/Spektori i lejeve, liçencave dhe administrimit të pronave publike, në lidhje me debinë nga qeraja e tokës bujqësore, na u vu në dispozicion informacioni i paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme, sipas njësive administrative, të familjeve që kanë marrë tokë bujqësore në përdorim (me qira), trashëguar nga ish komunat.

| Deri në 31.12.2022 | | | Debi e 2022 paguar në 2023 | | Vetëm viti 2023 | | Deri në 31.12.2023 | | |
|--------------------------------------|---------------------------|------------------------|--|--------------|-----------------------|----------------|--|-----------------------------|----------------|
| Numri i debitorve deri ne 31.12.2022 | Vlera e Debise Progresive | Sip e dhene me Qera ha | Numri i debitorve qe kane paguar debine e 2022 ne 2023 | Vlera Totale | Debitorë te rinj 2023 | Vlera e debise | Sip totale e dhene me qera deri ne vitin 2023 ha | Numri Progresiv i debitorve | Vlera e debise |
| 17 | 429,318 | 156,633 | 5 | 73,432 | 33 | 741,846 | 156,633 | 45 | 1,097,732 |

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar më sipër, rezulton se numri i debitorëve nga viti 2022 në vitin 2023 ka ardhur në rritje me 28 debitorë, ku bie në sy që është relativisht i lartë numri i debitorëve të rinj prej (33) në vlerën e detyrimit prej 741,846 lekë ose 1.7 herë më shumë se vlera e debisë progresive në fundin e vitit 2022; vlera e debisë progresive deri në fund të vitit 2023 është 1,097,732 lekë për 45 debitorë.

Vlera 1,097,732 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë. Gjendja debitorë në mënyrë të detajuar sipas Njësive Administrative, është paraqitur Aneksit A7-A12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

- Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2023 në Bashkinë Gjirokastrë, është si më poshtë:

| Nr. | Lloji Biznesit | Gjendja në fillim | Regjistrime të reja | Mbyllur aktiviteti | Gjendja në fund të vitit |
|-----------------|----------------|-------------------|---------------------|--------------------|--------------------------|
| 1 | Biznesi vogël | 1,056 | 119 | 123 | 1,052 |
| 2 | Biznesi i madh | 236 | 9 | 23 | 222 |
| Gjithsej | | 1,292 | 128 | 146 | 1,274 |

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se Bashkia Gjirokastrë e ka mbyllur vitin 2022 me 1,292 biznese aktive në total, prej të cilëve 1,056 janë biznesi i vogël dhe 236 janë biznesi i madh; janë në total 128 regjistrime të reja nga të cilat 119 janë biznesi i vogël dhe 9 biznesi i madh;

- Kanë mbyllur aktivitetin gjithsej 146 biznese prej të cilëve 123 janë biznesi i vogël dhe 23 janë biznesi i madh.

- Bashkia Gjirokastrë në fund të vitit 2023 ka të regjistruar në total 1,274 biznese ose 18 biznese më pak se në mbyllje të vitit 2022, prej të cilëve 1052 ose 4 më pak se në vitin 2022 janë biznesi i vogël dhe 222 ose 14 më pak se në vitin 2022 janë biznesi i madh.

Pra rezulton se numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, ka ardhur në rënie nga viti 2022 në vitin 2023 me një numër prej 18 biznesesh. Rënia e numrit të subjekteve shoqërohet edhe me rënie të vlerës së të ardhurave nga taksat dhe tarifat.

Nga auditimi u konstatua se DAV nuk ka një analizë mbi arsyet e rënies së numrit të bizneseve gjë e cila do të shoqërohej me hartimin e një plani masash apo strategjish për suportin e iniciativave për zgjerimin e aktivitetit tregëtar në territorin e bashkisë dhe për rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Konstatohet se numri i aktiviteteve të mbyllura ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 56 subjekte, nga të cilët 41 janë subjekte të klasifikuara si Biznes i vogël dhe 15 janë subjekte të klasifikuara si Biznes i madh.

- Një përmbledhje e debisë së vitit 2023 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme, në lekë:

| Kategoria e subjektit | | Nr. i subjekteve | Debia |
|-----------------------|---------------------|------------------|--------------------|
| A | Biznesi i Vogël | 906 | 49,632,557 |
| B | Biznesi i Madh | 59 | 16,808,191 |
| Nëntotali | | 965 | 66,440,562 |
| C | Kategoria Familjare | 11,794 | 91,715,152 |
| TOTALI | | 12759 | 158,155,714 |

Burimi:Bashkia Gjirokastrë

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelë rezultojn vlera e debisë 66,440,562 lekë nga biznesi i vogël dhe nga biznesi i madh, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

- Të dhëna të përmbledhura mbi debitorët e taksa e tarifa familjare për: truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim për vitin vitin 2023 janë si më poshtë:

| Nr. | Njësitë Administrative | Detyrimi për taksat e tarifave 2023 | |
|--------------|------------------------|-------------------------------------|-------------------|
| | | Nr. Familje | Vlera |
| 1 | Nj.Administrative (6) | 3,117 | 24,618,238 |
| 2 | Qyteti | 8,677 | 67,096,914 |
| TOTAL | | 11,794 | 91,715,152 |

Burimi:Bashkia Gjirokastrë

Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave/Bashkia Gjirokastrë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultojn se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016. Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m² për Bashkinë Gjirokastrë. Llogaritja e vlerës është (Sip. Objektivit* 32,105 * 0.5%). Drejtoria e Urbanistikës ka përpiluar një regjistër elektronik mbështetur në informacionin shkresor që ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastrë dhe ajo e Përgjithshme në periudha një mujore i kanë dërguar Bashkisë Gjirokastrë, listën e qytetarëve/subjekteve, të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit. Rezultojn se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Gjirokastrë/DTT dhe ASHKDV Gjirokastrë, por Bashkia Gjirokastrë mjaftohet me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK-DV Gjirokastrë dhe nga paraqitja e qytetarëve të interesuar për të bërë pagesat në zyrat e Bashkisë. Ky informacion duhet të përmbajë të gjithë parametrat mbi të cilët llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Të ardhurat nga TNI për vitin 2023 janë si më poshtë:

| Leje Legalizime | Vlera në lekë | Debia në nr | Debia në vlerë | Statusi |
|----------------------|----------------|-------------|----------------|---------|
| 60 | 1,413,963 | 9 | 162,160 | - |
| Leje Ndërtimi | | | | |
| 72 | 24 / 2,968,655 | 0 | 0 | √ |
| | 48 / 247,000 | 0 | 0 | |

Burimi:Bashkia Gjirokastrë

Situata debitoare për TNI ndër vite, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

| Viti | Numri i debitoreve | Vlera totale | Statusi aktual |
|------------------------------|--------------------|------------------|----------------|
| 31.12.2021 progresive | 64 | 1,528,969 | debitor |
| 31.12.2022 progresive | 76 | 1,690,840 | debitor |
| 31.12.2023 progresive | 85 | 1,903,345 | debitor |

Burimi:Bashkia Gjirokastrë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, rezultojn se pavarësisht se numri i familjeve që kanë aplikuar për leje legalizimi të objekteve dhe që nuk kanë paguar TNI ka ardhur në rënie nga viti në vit, vlera e debisë deri në 31.12.2023 mbetet e lartë në shumën

totale progresive 1,903,345 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

- Gjithashtu Drejtoria e Urbanistikës /Bashkia Gjirokastrë, ka të plotësuar në regjistrin e vet elektronik të dhënat që përmban Vendimi për lejen e legalizimit: numrin e Zonës kadastrale, numrin e pasurisë, numrin e Vendimit, datën e miratimit, sipërfaqen etj; Kjo sjell dhënien e informacionit të detajuar mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Lejet e ndërtimit për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin A13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore.

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se detyrimet e papaguara ndër vite (progresive) deri në 31.12.2022 janë 158,286,367 lekë për 12,517 debitorë: 11,485 debitorë familjarë, 104 debitorë nga BM dhe 928 debitorë nga BV;

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2023 janë bërë pagesa nga 11,795 debitorë në vlerën 57,552,226 lekë, ku arkëtimet nga debitorët familjarë zënë 64.6% e totalit të arkëtimeve ose 42.2% e totalit të detyrimeve familjare;

Për vitin 2023 është krijuar debi e re në vlerën totale 57,121,573 lekë: ku 40,790,000 lekë nga taksat dhe tarifat familjare ose 71.4% e totalit të detyrimit të ri; 3,910,389 lekë nga BM dhe 12,421,184 lekë nga biznesi i vogël ose 21.7% e totalit të debisë së re. Në fund të vitit 2023 debia progresive ka qenë në vlerën 158,155,714 lekë nga të cilat: 91,715,152 lekë nga debitorët familjarë ose 58% e vlerës totale; 16,808,191 lekë nga debitorët e biznesit të madh ose 10.6% e vlerës totale dhe 49,632,371 lekë nga debitorët e biznesit të vogël ose 31.4% e vlerës totale progresive të debisë.

Të dhënat e përmbledhura mbi debitorët janë paraqitur në Aneksin A14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Të ardhurat nga tregjet.

Bashkia Gjirokastrë vjel të ardhura nga dy tregje: Tregu agrorshqimor dhe tregu industrial, nëpërmjet Sektorit të Menaxhimit të Ndërmarrjeve dhe Tregjeve, të ardhurat nga të cilët janë paraqitur më poshtë:

| Emërtimi | Nr. i Tregëtarëve | Nr. i debitorëve | Vlera e debisë 31.12.2023 | % |
|--------------------|-------------------|------------------|---------------------------|-------------|
| Tregu Agrorshqimor | 15 | 15 | 331,500 | 100 |
| Tregu industrial | 69 | 15 | 246,000 | 21.7 |
| 2 | 84 | 30 | 577,500 | 35.7 |

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelë, rezulton se vlera e debisë deri në fund të vitit 2023 është 577,500 lekë në total për të dy tregjet. Theksojmë faktin se afati fundor për pagesën e taksave të biznesit të vogël është 30.06.2024; Në tregun ushqimor janë 15 tregëtarët pa paguar ende taksën vjetore të vitit 2023 ose 100% e tyre në vlerën 331,500 lekë; në tregun industrial janë 15 tregëtarë nga 69 gjithsej pa paguar taksën vjetore ose 21.7% e tyre në vlerën 246,000 lekë. Në total numri i debitorëve për vitin 2023 është 30 ose 35.7% dhe me vlerë të debisë (vjetore) 577,500 lekë.

Për subjektet aktiviteti i të cilëve klasifikohen si biznes i madh dhe zënë peshën kryesore të të ardhurave të bashkisë, debia e tyre është si më poshtë:

| Aktiviteti | Numri i Debitorëve | | Vlera e debisë | |
|---------------|--------------------|-----------|----------------|----------------|
| | B. Madh | B. Vogël | B. Madh | B. Vogël |
| Hoteleri | 0 | 48 | 0 | 301,930 |
| Ndërtim | 5 | - | 633,275 | - |
| Banka | 0 | - | 0 | - |
| Transport | 1 | 4 | 111,000 | 163,625 |
| Totali | 6 | 52 | 744,275 | 465,555 |

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Nga analiza e debitorëve, rezultoi se:

Për biznesin e vogël

1. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 2, në vlerën totale 47.730 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë 2, në vlerën 802,423 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë 24, në vlerën lekë 1,184,709 lekë;

Për biznesin e madh

Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 47, në vlerën totale 11,917,418 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë 6, në vlerën 3,066,665 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë 11, në vlerën lekë 6,085,928 lekë;

Debitorë problematikë = 92, në shumën progresive 23,104,873 lekë.

Konstatohet se në Bashkinë Gjirokastrë nuk janë zhvilluar takime të GMS ku të trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për minimizimin e vlerës së debisë.

2. Aplikimi i penaliteteve dhe shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe në ASHK;

3. Njoftimi i subjekteve debitorë dhe familjare kryhet me anë të shërbimit postar, por edhe nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve.

Sa më sipër arrihet në *konkluzionin* se nga struktura tatimore e bashkisë Gjirokastrë, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar neni 9 “*Të drejtat dhe përgjegjësitë*” pika 1.3., neni 35, “*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*”, me Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “*Për sistemin e taksave vendore*”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Taksa e parkimit.

Kjo taksë u vilet poseduesve të automjeteve të ndryshme të cilët parkojnë në vende publike. Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takse është DTTV në bashkëpunim me Drejtorinë e shërbimeve/transportit, bazuar në kontratat që lidh me subjektet apo individët që janë të interesuar për vend parkimi.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se *për vitin 2022* janë parashikuar 1,317 mijë lekë dhe janë vjelë 1,857 mijë lekë; *për vitin 2023* janë parashikuar 6,032 mijë lekë dhe janë vjelë 4,637 mijë lekë ose 2,780 mijë lekë më shumë se viti paraardhës, por me një realizim 77%.

Burimi i krijimit të të ardhurave jotatimore.

Nga gjobat:

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave në Paketën Fiskale të miratuar janë parashikuar gjoba për kategori të ndryshme kundërvajtjesh.

Duke iu referuar tabelës përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar 300 mijë lekë dhe janë realizuar 737 mijë lekë; ndërsa për vitin 2023 janë parashikuar 700 mijë lekë dhe realizuar 2,392 mijë lekë. Rezulton se kjo vlerë përfshin vetëm vlerën e gjobave të llogarituara nga Drejtoria e të ardhurave për mospagesë në afat të tyre.

- Gjoba nga Policia bashkiake për vitin 2023 nuk ka informacion

- Gjoba nga IMTV për vitin 2023 janë vendosur 91 gjoba në vlerën totale 27,650,000 lekë, nga të cilat nuk është paguar vullnetarishtasnjë gjobë dhe janë nëdërguar në gjykatë për tu kthyer në titull ekzekutiv.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/me këste:

Nga DAV/Bashkia Gjirokastrë për shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura, është aplikuar edhe lidhja e Akt marrëveshjeve për pagesë me këste nga ana e debitorëve. Situata e

detyrimeve për subjektet të cilat kanë lidhur Akt marrëveshje me Bashkinë Gjirokastrë gjatë vitit 2023, është paraqitur në Aneksin A15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga qira trualli/të tjera:

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor dhe statistikor (tabelar) rezultoi se nuk ka debitorë për truall të dhënë me qira.

Nga qira ndërtese:

Nga të dhënat pasqyruar në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar 123 mijë lekë të ardhura nga qiratë dhe janë realizuar 97 mijë lekë; gjatë vitit 2023 janë parashikuar 123 mijë lekë të ardhura dhe janë realizuar 545 mijë lekë.

| Nr. | Subjekti | Vendndodhja | Sipërfaqe m ² | Vlera sipas kontratës |
|-----|--------------|-------------|--------------------------|-----------------------|
| 1 | Adrian Shehu | Gjirokastrë | 66 | 29,000 |
| 2 | Galip Ponde | Gjirokastrë | 66 | 29,000 |

Nga auditimi rezultoi se pagesat e vlerës së qirasë paguhen nga qiramarrësi para lidhjes së marrëveshjes dhe kontratës. Kjo ka sjellë garantimin e arkëtimit të detyrimit dhe parandalimin e krijimit të debitorëve.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB, u konstatua se në Bashkinë Gjirokastrë gjatë periudhës objekt auditimi, kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 7 subjekte. Nga auditimi rezulton se nga inspektimet e kryera në terren, subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren ushtrojnë normalisht aktivitetin dhe rezultojnë aktivë në QKB.

Nga komunikimi me DAV *na u përcoll ky informacion:*

“A.N.” për arsye se ka firmë ndërtimi dhe disponon makina, Administratori ngre pretendim se kryen aktivitet për konsumim vetjak nuk e përdor karburant për shitje;

Territori (në Shtepëz) ku ushtronte aktivitetin “F.2.” është zëvendësuar me aktivitetin e subjektit “K.S.”.

Nga dokumentacioni i venë në dispozicion **rezulton** se:

- Në Bashkinë Gjirokastrë gjatë vitit ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 18 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre dhe 1 subjekt që e ka për furnizim të automjeteve në pronësi të tij. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregëtimit dhe pagesat e tyre rezultojnë: 15 subjekte kanë kryer pagesë të plotë të detyrimit deri në 31.12.2022 në vlerën totale 14,400,000 lekë; 2 subjekte, “E.G.” dhe K.S.” janë subjekte që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 2 vendndodhje të ndryshme (kanë 2 pika shitje karburanti) dhe kanë bërë pagesë të pjesshme të detyrimit deri në 31.12.2023 në vlerën totale 550,000 lekë për një prej pikave, nëpërmjet Akt Marrëveshjeve të lidhura me Bashkinë Gjirokastrë; “K.S.”, Shtepëz, në vitin 2020 ka nisur aktivitetin e tij në territorin dhe mjetet e instaluar teknike të aktivitetit që ka patur subjekti “F.2.”; 1 subjekt – “A.N.” nuk ka paguar dhe nuk e njeh detyrimin prej 1,000,000 lekë. Sa më sipër **konstatohet** se:

- për subjektet “F.2.”, Shtepëz dhe “E.G.”, Ura e lumit, nga ana e DAPPLL nuk kishte informacion të saktë mbi detyrimin referuar lejes së përfutur, pasi i përkasin periudhës 2015-2020 dhe 2018-2023 në të cilën përfshihen edhe ndryshimet ligjore mbi procedurat e pajisjes me leje subjekteve që tregëtojnë karburante dhe hidrokarbure dhe të lëvizjes së shpeshtë të personelit brenda strukturës së Drejtorisë gjatë kësaj periudhe;

- subjekti “A.N.” nuk ka paguar dhe nuk e njeh detyrimin prej 1,000,000 lekë;

Referuar informacionit të venë në dispozicion nga DAPPLL rezulton se vetëm për 3 subjekte “E.G.”, “K.S.”, Shtepëz dhe “A.N.”, detyrimi në vlerën totale është 3,450,000 lekë; ndërsa për 2 subjektet “E.G.” dhe “F.2.” nuk ka informacion të saktë mbi detyrimin e tyre ndaj Bashkisë Gjirokastrë.

Konkluzion: Nga Titullari i Bashkisë, GMS dhe DAV nuk ka asnjë analizë të situatës së tre subjekteve: “A.N.”, “F.2.” dhe “E.G.”, Ura e Lumit, për të marrë masa me qëllim zgjidhjen shteruese të këtij ngërçi, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi (konstatuar edhe nga grupi i auditimit të mëparshëm, për të cilin është lënë dhe rekomandim). Gjithashtu për subjektin “K.S.”, Shtepëz i cili ushtron aktivitetin e vet te territori i braktisur i “F.2.” nga auditimi dhe komunikimi me DAPPLL, rezulton informacion jo i plotë mbi praktikën e dhënies së lejes për ushtrimin e aktivitetit për periudhën nga 2020 e në vijim.

Subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre janë paraqitur në Aneksin A16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga aktiviteti i MZSH.

Gjatë vitit 2023 MZSH/Bashkia Gjirokastër nga aktiviteti i saj ka këtë informacion:

| Sektori i ndërhyrjes/zjarre | Objekte banimi | Objekte shërbimi | Pyje e kullota | Automjete | Totali |
|---|------------------|-------------------|-----------------------|-------------------|----------------|
| | 18 | 7 | 53 | 10 | 88 |
| Sektori i parandalimit | Akte kontrolli | Akt teknik zjarri | Leje objekti | Ekspertiza zjarri | 50 |
| | 44 | 13+2 rinovime | 15 | 20 | |
| Inspektive | Objekte shërbimi | Aktivitet akomod | Obj didakti/administr | Impia.karburanti | 44 |
| | 26 | 6 | 2+1 | 9 | |
| Totali i arkëtimeve nga MZSH (në lekë) | | | | | 213,000 |

Burimi: Bashkia Gjirokastër

Referuar informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se nga aktiviteti i saj MZSH për vitin 2023 nga shërbimet e kryera ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Gjirokastër 213,000 lekë.

Përfundimet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese.

Taksa mbi Ndërtesën dhe tarifrat e tjera familjare:

Referuar VKB nr. 92 datë 24.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Gjirokastër 2023”, janë miratuar kategoritë që përfitojnë lehtësira dhe përjashtime nga taksa mbi ndërtesën. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave.

Numri i familjeve me lehtësi fiskale është paraqitur në Aneksin A17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezulton se DAV ka një informacion të plotë për familjet që përfitojnë nga paketa fiskale, të cilat përbëjnë rreth 15% të totalit të familjeve në Bashkinë Gjirokastër dhe shuma prej 5,519 mijë lekë tregon efektin negativ në të ardhurat e bashkisë nga njëra anë dhe efektin pozitiv social për komunitetin në anën tjetër.

Komisioni i Apelit Administrativ:

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur Komisionin e Apelit Tatimor, i cili shqyrton ankimin e taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimin të zyrës së taksave. Ky mosveprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 7 i tij;

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultoi se debia progresive deri në datën 31.12.2022 është 182,468,723 lekë për 17584 debitorë, ndërsa deri në datën 31.12.2023, debia progresive është 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë; janë kontabilizuar 15,931,835 lekë dhe si të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër për periudhën deri në 31.12.2023 në vlerën totale (progresive) janë 166,587,228 lekë.

Detyrimi ndaj Bashkisë Gjirokastër në mënyrë të detajuar është si më poshtë:

1. Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve për vitin 2023 është në vlerën **40,790,000** lekë dhe në vlerën progresive **91,715,152** lekë.
2. Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të vogël për vitin 2023 është në vlerën **12,421,184** lekë dhe vlera progresive **49,632,371** lekë;
3. Detyrimi nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të madh për vitin 2023 është **3,910,389** lekë dhe në vlerën progresive **16,808,191** lekë.

4. Detyrimi nga mospagimi i qirasë nga toka bujqësore vendore për vitin 2023 është **741,846** lekë për 33 familje dhe në vlerën progresive **1,097,732 lekë** për 45 familje.
5. Detyrimi nga mospagimi i TNI për vitin 2023 është **162,160** lekë për 9 familje dhe në vlerën progresive **1,903,345lekë**për 85 familje.
6. Detyrim nga mospagimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2023 është **2,017,024** lekë dhe në vlerën progresive **19,362,272 lekë**.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- 2.3.1. *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.*
- 2.3.2. *Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.*
- 2.3.3. *Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.*
- 2.3.4. *Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.*

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023:

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme””, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 2428 prot., datë 28.03.2024, të përbëra si vijon:

- Formati nr. 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
 - Formati nr. 2: Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);
 - Formati nr. 3: Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow);
 - Formati nr. 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
 - Formati nr. 5: Pyetësor dhe shënimet shpjeguese;
 - Formati nr. 6: Investimet dhe burimet e financimit;
 - Formati nr. 7/a: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike);
 - Formati nr. 7/b: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto);
 - Formati nr. 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave;
- Pasqyrat financiare janë nënshkruar nga znj. A.K., si Nëpunës Zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. F.G., Nëpunës Autorizues.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke, (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, u konstatua se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

Mosndryshueshmërinë e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera, pohojmë se:

Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin “EXCEL” dhe jo me program të veçantë.

Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

Në tërësi, organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë hartuar me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues, si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësi, duke argumentuar shkakun e veprimit, të shoqëruar me urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshëm për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastrë për aktivitetin ekonomik-financiar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë

tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023, rezultoi se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Gjyrokastër për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës, rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në CASH për vitin 2023.

Materialiteti për shpenzimet është vlerësuar 20,968,969 lekë, ndërsa për të ardhurat është vlerësuar 23,496,071 lekë. Përlllogaritja e vlerës së materialitetit është paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023:

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 73-106, ka dalë Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr. 721, datë 02.10.2023 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 01.01.2023-31.12.2023” dhe është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen fizike të aktiveve me gjendjen kontabël, i përbërë nga 5 anëtarë, me afat përfundimi në datën 15.12.2023.

Mbajtja e kontabilitetit për vitin 2023:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u konstatua se:

| | |
|--|--------------------|
| Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet: | 3,259,025,210 lekë |
| Aktivet: | 3,385,842,347 lekë |
| Pasivet: | 126,817,137 lekë |
| Aktivet neto: | 3,259,025,210 lekë |

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurtra në datën 31.12.2023 paraqiten në vlerën 471,598,015 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre”, në shumën 271,123,837 lekë,

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, në shumën 110,456,412 lekë,

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”, në shumën 90,017,766 lekë.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore 2023, sipas Formatit nr. 1, Pozicioni Financiar, është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre”, janë paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”, në shumën 271,123,837 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin përbëhet nga: gjendja e Llogarisë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, në vlerën 274,935,769 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 234,324,466 lekë, granti i papërdorur në vlerën 173,128,747 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 61,195,719 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje”, në shumën 36,799,371 lekë, minus ndryshimin e gjendjeve të inventarit që në fund të vitit

paraqitet me shtesë në vlerën 40,611,304 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “*Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor*” në Formatin nr. 3 “*Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow) sipas metodës direkte*” (Teprica në fillim të vitit në vlerën 288,591,964 lekë - Transferta të tjera në vlerën 57,982.375 lekë - Veprimtaritë e investimeve në vlerën 58,340,217 lekë+ Fondet buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 735,403,484 lekë + arkëtimet e hyra cash në vlerën 203,066,074 lekë - PAGESA për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 839,615,093 lekë), të paraqitura në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, janë paraqitur në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në datën 31.12.2023, paraqiten në vlerën 110,456,412 lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “*Materiale*” në vlerën 37,019,871 lekë dhe nga llogaria 32 “*Inventar i imët*”, në vlerën 73,436,541 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 40,611,304 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” në shumën - (40,611,304) lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 37,019,871lekë, e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 32 “Inventar i imët”, ka vlerën 42,780,873 lekë vlerë e cila është e barabart me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, përbëhen nga: Llogaria 411 “*Klientë e llogari të ngjashme*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 90,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e taksave të pullës nga aktiviteti i Gjendjes Civile, sipas Aneksit PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 465 “*Efekte për t’u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë*”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 198,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e letrave me vlerë (taksë pulle) të pashpërndara.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 45,884,227 lekë, sipas Aneksit PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 11,898,112 lekë në nga IMTV në vlerën 7,350,000 lekë dhe nga kontabilizimi i subjekteve (nga rekomandimet e KLSH-së) në vlerën 4,545,112 lekë.

Analiza e gjëndjes së llogarisë “*Debitorë të ndryshëm*” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën debitorë analitikë në fund të vitit 2023, sipas Aneksit PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 43,845,539 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe kreditorë të ndryshëm.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM):

Llogaritë e Klasës 20 “*Aktivet Afatgjata Jomateriale*”, përbëhen nga llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*”, në aktiv të bilancit dhe paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,969,655 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 20,520,894 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 40,345,713 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 40,518,286 lekë, ku diferenca në rritje prej 172,573 lekë është krijuar gjatë vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Aktivet afatgjata materiale (AAM):

Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet me vlerë neto 13,743,625 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 32,668,475 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 13,743,625 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 32,668,475 lekë, ku diferenca në rritje prej 18,924,850 lekë është bërë gjatë vitit 2023 nga shpronësimi i hapësirave private për zgjerimin e varrezave publike sipas Aneksit PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 816,939,482 lekë dhe në mbyllje të vitit paraqitet 2023 në vlerën 825,846,004 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,101,157,656 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,153,529,757 lekë. Pra ka rritje në vlerën 52,372,101 lekë, që përbëhet nga shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si më poshtë:

1. Objekti “*Ndërhyrje në nënobjekte plotësuese në teatrin “Zihni Sako”*”, në vlerën 8,900,178 lekë;
2. Objekti “*Rehabilitimi dhe përshtatja për zyra i ambienteve të brendshme të katit të dytë të konviktit të djemve*”, në vlerën 3,762,843 lekë;
3. Objekti “*Riparime në shkollat e arsimit parauniversitar “Koto Hoxhi”*”, në vlerën 1,447,792 lekë;
4. Objekti “*Hidroizolim, rehabilitim në shkollën “Çajupi”*” në vlerën 1,523,586 lekë;
5. Objekti “*TVSH Projektin “Zhvillimi alternativ ekonomik në zonë në rrezik të lartë Lazarat”*”, në vlerën 57,015 lekë;
6. Objekti “*Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit*” në vlerën 35,240,997 lekë;
7. Objekti “*Rehabilitimi i shkollës “Bilal Golemi”*”, në vlerën 1,439,690 lekë.

Shtesat e llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, janë paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,497,754,617 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,435,947,903 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,033,185,491 lekë dhe në vitin 2022 paraqitet në vlerën 2,019,415,999 lekë. Pra ka rritje në vlerën 13,769,492 lekë, që përbëhet nga shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si më poshtë:

1. Objekti “*Rikonstruksion rruge dhe muri mbajtës në Kodrën e shtufit*” në vlerën 1,490,801 lekë;
2. Objekti “*Riveshje asfaltike në rrugen Ibrahim Sino*” në vlerën 5,625,963 lekë;

3. Objekti “*Rikonstruksioni i rrugicës “Kapo Baco”*” në vlerën 6,652,728 lekë. Shtesat e llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, janë paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune*”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 19,036,695 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,732,056 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjëndja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 91,013,315 lekë dhe në vitin 2022 paraqitet në vlerën 87,324,165 lekë.

Për vitin 2023 kjo llogari është shtuar në vlerën 5,939,380 lekë, për blerje me pagesë si më poshtë:

1. Freskuese dhe ventilator në vlerën 39,600 lekë.
2. Kontenier plastik në vlerën 5,116,500 lekë.
3. Soba druri në vlerën 185,760 lekë.
4. Linja e destilimit në vlerën 597,520 lekë.

Është pakësuar për vlerën 2,250,230 lekë për lëvizjet brenda aktiveve.

Shtesat e llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, janë paraqitur në Aneksin PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 215 “*Mjete transporti*”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 42,790,538 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 47,452,293 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjëndja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 89,357,913 lekë dhe në vitin 2022 paraqitet në vlerën 81,378,031 lekë.

Për vitin 2023 kjo llogari është shtuar në vlerën 7,979,882 lekë, nga të cilat 6,564,000 lekë për blerje me pagesë si më poshtë:

1. Blerje e një mjeti Caterpillar në vlerën 3,816,000 lekë;
2. Minifiadromë me zinxhirë në vlerën 2,748,000 lekë.

Lëvizje në rritje brenda sistemit në vlerën 1,415,882 lekë për mjetin Xhip Pajero.

Shtesat e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” janë paraqitur në Aneksin PF20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria kontabël 218 “*Inventar ekonomik*”, përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare, gjëndja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 67,158,683 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 56,218,949 lekë. Sipas Formatit nr. 7/B “*Gjëndja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 141,052,401 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën kontabël 144,039,354 lekë.

Në këtë gjëndje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 2,916,003 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 199,000 lekë. Shtesa brenda sistemit të aktiveve në vlerën 199,000 lekë.

Pakësuar për vlerën 128,050 lekë për lëvizjet brenda aktiveve,

1. Materiale zyre (kompjutera), në vlerën 1,051,923 lekë;
2. Materiale zyre (karrige), në vlerën 50,400 lekë;
3. Materiale logjistike (dylbi) në vlerën 132,000 lekë;
4. Materiale audio vizive në vlerën 853,680 lekë;
5. Figura dekorative për dekorin e qytetit në vlerën 828,000 lekë.

Shtesat e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, janë paraqitur në Aneksin PF22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, është paraqitur në Aneksin PF23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e aktiveve afatgjatë në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr. 7/A të PF “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, sipas Aneksit PF24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023, Bashkia Gjirokastrë:

Llogaria 219 “*Amortizimi i AAGJM & AAJM*”: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastrë në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (1,003,024,296) lekë. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 219 “*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar*”, paraqitet me shtesë prej (143,901,722) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i shtesave në llogaritë e mëposhtme:

| | |
|--|-----------------|
| Llogaria 202: Amortizim i studimeve e kërkimeve | 3,621,334 lekë |
| Llogaria 212: Ndertime e konstruksione | 43,465,579 lekë |
| Llogaria 213: Rruge rrjete vepra ujore | 75,576,205 lekë |
| Llogaria 214: Instalime teknike, pajisje, vegla pune | 6,244,019 lekë |
| Llogaria 215: Mjete transporti | 3,318,127 lekë |
| Llogaria 218: Inventari ekonomik | 14,054,737 lekë |
| Pakësime të amortizimit nga lëvizja brenda aktiveve | |
| Llogaria 214: Instalime teknike, pajisje, vegla pune | 2,250,230 lekë |
| Llogaria 218: Inventari ekonomik | 128,050 lekë |

Pasqyra statistikore nr. 7/B “*Akivet afatgjata me vlerë neto*”, është paraqitur në Aneksin PF25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Gjirokastrë, janë si më poshtë:

| | |
|---|-----|
| Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje | 5% |
| Inventari ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) | 20% |
| Pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) | 25% |
| Mjetet e transportit | 20% |

Llogaria 231 “*AAGJM, “Investime në proces*”, në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 261,728,261 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 471,857,758 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor 2023.

Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave, është paraqitur në Aneksin PF26, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 231 “*AAGJM, “Investime në proces*”, sipas burimeve të financimit, Formatin nr. 6, është paraqitur në Aneksin PF27, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

PASIVET (DETYRIMET):

Pasivet Afatshkurtra: Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Gjirokastrë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., në fund të vitit 2022 ka qenë 104,672,835 lekë dhe në fund të vitit 2023 ka qenë 126,817,137 lekë, me një rritje prej 22,144,302 lekë.

Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, është paraqitur në Aneksin PF28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 42, “*Detyrime ndaj personelit*”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 29,287,377 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, sipas Aneksit PF29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Gjendja e kësaj llogarie, sipas dokumenteve të bankës të muajit janar 2024, është paraqitur në Aneksin PF30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 431, “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*”, paraqitet në vlerën 1,204,062 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor, sipas Aneksit PF31, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e kësaj llogarie, sipas dokumenteve të bankës të muajit janar 2024, është paraqitur në Aneksin PF32, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 435, “*Sigurime shoqërore*” dhe llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*”, paraqet vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhen në muajin janar 2024 dhe janë përkatsisht në vlerat 8,556,899 lekë dhe 1,180,959 lekë, sipas Aneksit PF33, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e kësaj llogarie, sipas dokumenteve të bankës të muajit janar 2024, është paraqitur në Aneksin PF34, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*”, përfshin detyrimet e letrave me vlerë që janë furnizuar dhe nuk janë përdorur deri në fund të vitit 2023, për vlerën 828,000 lekë, lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023, janë paraqitur në Aneksin PF35, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,085,920 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 36,799,371 lekë, prej të cilës 124,500 lekë është taksa e pullës në fund të vitit 2023. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila është paraqitur në Aneksin PF36, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, përmban detyrimet për fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqate, të cilat për vitin 2024 paraqiten në shumën 3,053,135 lekë, të cilat në mënyrë analitike janë paraqitur në Aneksin PF37, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në mënyrë analitike, detyrimet për vendime gjyqësore janë paraqitur në Aneksin PF38, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”, përfaqëson detyrime për t’u derdhur nga debitorë të ndryshëm që për vitin 2023 është e pasqyruar për vlerën 46,172, 227 lekë.

Fondi i konsoliduar për vitin 2022, sipas formatit nr. 1, është paraqitur në Aneksin PF39, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet në lidhje me pagat:

Struktura organizative për vitin 2023, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhërin nr. 945, datë 07.12.2022. Numri maksimal i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 98, datë 16.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1219/1 prot., datë 20.12.2022, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me Urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. 2, datë 04.01.2023.

Për vitin 2023 numri i punonjësve është 615+ 6 punonjës të Gjendjes Civile = 621 punonjës gjithsej. Në fakt, sipas listëpagesave janë paguar gjithsej 608 punonjës. Nuk ka pasur tejkallim të numrit të punonjësve dhe nga verifikimi i listëpagesave, u konstatua se është zbatuar struktura e miratuar me VKB-në dhe urdhërin përkatës të Kryetarit të Bashkisë.

Listëpagesat janë firmosur nga Drejtori i Financës, znj. A.K. dhe nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, z. F.G..

Është përgatitur përmbledhësja e listëpagesave, e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe Kryetari Bashkisë.

Listëprezencat janë mbajtur dhe firmosur nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, znj. M.S. dhe Kryetari Bashkisë.

Hartimi i listëpagesave mbi bazën e listëprezencave të nënshkruara nga përpiluesi:

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e periudhës maj-qershor dhe tetor-nëntor 2023, nga ku u konstatua se janë plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore.

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, janë bërë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë deklaruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë brenda afateve ligjore. Për periudhën maj-qershor, janë paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 357, datë 05.05.2023 në vlerën 10,200,074 lekë dhe Urdhër Shpenzimin nr. 447, datë 05.06.2023 në vlerën 10,105,373 lekë. Për periudhën tetor-nëntor janë paguar me Urdhër Shpenzimin nr. 838, datë 04.10.2023 në vlerën 11,152,295 lekë dhe me Urdhër Shpenzimin nr. 948, datë 06.11.2023 në vlerën 11,197,263 lekë.

Transaksionet financiare nëpërmjet arkës:

Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2023, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 156,400 lekë, të evidentuara si më poshtë:

| | |
|--|-------------|
| 1. Arka në lekë Bashkia Qendër në vlerën | 10,200 lekë |
| 2. Arka në lekë Njësia Administrative Lazarat në vlerën | 30,400 lekë |
| 3. Arka në lekë Njësia Administrative Antigone në vlerën | 10,200 lekë |
| 4. Arka në lekë Njësia Administrative Picar në vlerën | 24,400 lekë |
| 5. Arka në lekë Njësia Administrative Lunxhëri në vlerën | 37,000 lekë |
| 6. Arka në lekë Njësia Administrative Odrie në vlerën | 9,800 lekë |
| 7. Arka në lekë Njësia Administrative Cepo në vlerën | 34,400 lekë |

Për arkën e letrave me vlerë gjatë vitit 2023 janë kryer veprimet:

Çelja në fillim të vitit në vlerën 738,000 lekë, arkëtime gjatë vitit në vlerën 900,000 lekë dhe pagesa në vlerën 1,440,000. Gjendja e letrave me vlerë në fund të vitit ka qenë në shumën 198,000 lekë.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës, u konstatua se të ardhurat nga arkëtimet e kryera janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit është zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e Thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës, i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Shpenzimet për aktivitete kulturore dhe artistike:

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në kontabilitetin e menaxhimit 60 kontrata nga të cilat 35 prej tyre janë me vlerë të madhe dhe 25 kontrata me vlerë të vogël, sipas paraqitjes në Aneksin PF40, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 33 aktivitete kulturore, për të cilat janë realizuar procedura prokurimi për zërin buxhetor Akomodim dhe Banera/postera. Pagesat për shërbimin artistik janë realizuar sipas VKM-së nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

Pajisja e Aktiveve Afatgjata Materiale me certifikata pronësie:

Nga verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se janë pajisur me certifikata pronësie 10 aktive/pasuri, si më poshtë:

1. Aktivi me nr. pasurie 186/13, zona kadastrale 2956, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe 835,759 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 26.03.2021.
2. Aktivi me nr. pasurie 186/12, zona kadastrale 2956, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe 48,500 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 26.03.2021.
3. Aktivi me nr. pasurie 881, zona kadastrale 3114, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe 418,358 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 11.11.2021.
4. Aktivi me nr. pasurie 873, zona kadastrale 2277, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe 729,657 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 11.11.2021.
5. Aktivi me nr. pasurie 883, zona kadastrale 2277, lloji i pasurisë “Pyll”, me sipërfaqe 251,341 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 11.11.2021.
6. Aktivi me nr. pasurie 871, zona kadastrale 2277, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe 8,437,289 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 11.11.2021.
7. Aktivi me nr. pasurie 8/379, zona kadastrale 8542, lloji i pasurisë “Truall”, me sipërfaqe 740 m², ndërtesë 382 m², data e certifikatës së pronësisë 20.01.2022.
8. Aktivi me nr. pasurie 15/179, zona kadastrale 8543, lloji i pasurisë “Truall”, me sipërfaqe 1,047 m², ndërtesë 0 m², data e certifikatës së pronësisë 28.01.2022.
9. Aktivi me nr. pasurie 368/242, zona kadastrale 1484, lloji i pasurisë “Truall”, me sipërfaqe 1292 m², ndërtesë 325 m², data e certifikatës së pronësisë 27.09.2022.
10. Aktivi me nr. pasurie 11/47+1-12, zona kadastrale 8541, lloji i pasurisë “Apartament”, me sipërfaqe 71 m², data e certifikatës së pronësisë 03.05.2023.

2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM

2.4.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Sipas Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për Bashkinë Gjirokastrë, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Gjirokastrë, të Qarkut Gjirokastrë”, e cila përmban 240 fletë dhe përfundon me numër rendor 1713.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, është miratuar lista e pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1, mbaron me numër 1700 dhe përbëhet nga 242 fletë. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe me shkresën nr. 3376, datë 14.06.2017 i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Në total, Bashkisë Gjirokastrë i janë transferuar “në pronësi” 1699 pasuri, pa përfshirë ish-komunat, të cilat nuk rezultojnë me dokumentacion pronësor, sipas Aneksit PP1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për ish-Komunën Lazarat:

Me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lazarat, të Qarkut Gjirokastrë”, është miratuar lista inventarit me 31 fletë dhe përfundon me numër rendor 157.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, është miratuar lista e pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Lazarat, në Bashkinë Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1, mbaron me numër 157 dhe përbëhet me 31 fletë. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe me shkresën nr. 3376, datë 14.06.2017 i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Për ish-Komunën Cepo:

Me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Cepo, të Qarkut Gjirokastrë”, është miratuar lista e inventarit me 83 fletë dhe përfundon me numër rendorë 612.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, është miratuar lista e pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Cepo, në Bashkinë Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1, mbaron me numër 612 dhe përbëhet me 83 fletë. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe me shkresën nr. 3376, datë 14.06.2017 i është dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Për ish-Komunën Picar:

Me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Picar të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 439 prona.

Numrat rendorë, 1-4 “Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1501 m²”.

Numrat rendorë, 5-8 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 269 m²”.

Numrat rendorë, 10, 20-25, 27, 28, 30, 34-38, 302-406 “Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore, në pronësi, shesh me sipërfaqe 79629 m²”.

Numrat rendorë 11-19, 26, 29, 31-33, 39 “Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 10329 m²”.

Numrat rendorë, 40-50, 55-58, 60-67, 69-70, 72-79 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 3986 m²”.

Numrat rendorë, 81-85 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe ndërtese 469 m²”.

Numrat rendorë, 86-87 “Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe totale 5181 m², nga kjo ndërtesë 113 m²”.

Numrat rendorë, 88-92 “Varrezat publike, në pronësi”.

Numrat rendorë, 263-271 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive arë, vreshta dhe pemëtore), në përdorim, me sipërfaqe 233.6 ha”.

Numrat rendorë 272-276, 281, 282, 285, 286, 294, 295, 299 (vetëm kanale të treta) “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 546 ha”.

Numrat rendorë 408-409 “Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi”.

Për ish-Komunën Antigone:

Me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Antigone të Qarkut të Gjirokastrës”, i janë kaluar 259 prona.

Numri rendor, 20-27, 252 “Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 12225 m², nga kjo ndërtesë 1408 m²”.

Numri rendor, 28-30 “Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore, në pronësi, me sipërfaqe totale 5720 m², nga kjo ndërtesë 440 m²”.

Numri rendor, 31-33 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik në pronësi, me sipërfaqe totale 340 m², nga kjo ndërtesë 300 m²”.

Numri rendor, 34 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative, në pronësi, me sipërfaqe totale 220 m², nga kjo ndërtesë 216 m²”.

Numri rendor, 35, 36, 38 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 690 m², nga kjo ndërtesë 270 m²”.

Numri rendor, 37 “Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 480 m²”.

Numri rendor, 39 “Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 4250 m²”.

Numri rendor, 40-43 “Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13815 m²”.

Numri rendor, 45-55 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 24.9 ha i është dorëzuar AKKP-së, në përdorim, me sipërfaqe 770.5 ha”.

Numri rendor, 56-60, 64, 72, 75 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive), në pronësi, me sipërfaqe 370 ha”.

Numri rendor, 80-220 “Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi”.

Numri rendor, 221-226, 253-259 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi”.

Për ish-Komunën Odrie:

Me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Odrie të Qarkut të Gjirokastrës”, i janë kaluar 136 prona.

Numrat rendorë 1, 2, 4, 5, 6, 8, 9, 11, 12, 13, 15, 16 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive), në përdorim, me sipërfaqe 791 ha”.

Numrat rendorë 3, 7, 10, 14, 17, 75, 76, 83, 84, 89, 92, 95, 96, (vetëm kanalet e treta) “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 375 ha”.

Numrat rendorë 18-23 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 563 m²”.

Numrat rendorë 24-26 “Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 696 m²”.

Numrat rendorë 27-29 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 329 m²”.

Numrat rendorë 30 “Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe 250 m²”.

Numrat rendorë 31-38 “Varrezat publike, në pronësi”.

Numrat rendorë 39-44 “Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1218 m²”.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm trojet) “Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim”.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm sheshet) “Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 39958 m²”.

Numrat rendorë 98-100 “Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi”.

Numrat rendorë 101-102 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi”.

Për ish-Komunën Lunxhëri:

Me VKM nr. 567, datë 27.06.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lunxhëri të Qarkut të Gjirokastrës”, i janë kaluar 701 prona.

Numrat rendorë 1-5, 701 “Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 16953 m², nga kjo ndërtesë 1670 m²”.

Numrat rendorë 6-7 “Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës, në pronësi, me sipërfaqe totale 6928 m², nga kjo ndërtesë 88 m²”.

Numri rendor 8 “Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 32 m²”.

Numrat rendorë 10-14 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13763 m².

Numrat rendorë 15-19, 21, 29, 30, 38, 62, 63, 66-68, 80-82, 85, 89, 91-101, 113-116, 147, “Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 43607 m²”.

Numrat rendorë 20, 24, 25, 28, 34-37, 39-46, 48-53, 57-59, 61, 64, 65, 69-79, 83, 84, 86-88, 90, 102-112, 118, 121-146, 149, 150, 154-446 “Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, sheshe me sipërfaqe 202969 m²”.

Numrat rendorë 22, 23, 26, 27, 31-33, 47, 54-56, 60, 117, 148, 151-153 “Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 15952 m², nga kjo ndërtesë 2704 m²”.

Numrat rendorë 447-449 “Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile, në pronësi, me sipërfaqe totale 1520 m², nga kjo ndërtesë 834 m²”.

Numrat rendorë 450-451 “Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi”.

Nga pasuritë e mësipërme nuk rezulton të jetë e regjistruar asnjë pasuri në regjistrat publike të pasurive të paluajtshme.

Për Bashkinë Gjirokastrë:

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Gjirokastrë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm nëpërmjet një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Bashkia Gjirokastrë nuk disponon dokument pronësie për asnjë nga pronat e transferuara, çka nënkupton se për to nuk ka kartelë pasurie në regjistrat publikë dhe se nuk është aplikuar në ASHK për kalimin nga sistemi i vjetër hipotekor në sistemin e ri të certifikimit, për zona kadastrale ku ka mbaruar procesi i regjistrimit fillestar.

Nga verifikimi i evidencave, rezultoi se:

Në Bashkinë Gjirokastrë nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administratimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupe pune ku të përcaktohet misioni dhe detyra e tyre për administrimin e asetëve si dhe struktura për ndjekjen e tyre.

2.4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Bashkia Gjirokastër ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 22,260 ha, i ndarë në 11 ekonomi pyjore sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar. Të dhënat për fondin pyjor/kullor janë paraqitur në Aneksin PP2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezultoi se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Gjirokastër nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.
- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr. 443/2016, nuk ka regjistruar në regjistrat kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor publik nuk është regjistruara asnjë sipërfaqe pyjore e transferuar.
- Në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

Në Bashkinë Gjirokastër janë lidhur 169 kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullor, nga të cilat kanë si objekt aktiviteti “Blegtori”. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 nuk ka asnjë debitor. Kontratat janë të detajuara në Aneksin PP3 dhe PP4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.5. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

- Kryetari i Bashkisë Gjirokastër ka miratuar Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit”, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 në Bashkinë Gjirokastër. “Plani i veprimi” është dërguar në KLSH me shkresën nr. 11761/1 prot., datë 21.12.2023 në tejkallim të afatit 20 ditor, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin e strukturave të ngarkuara me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
- Në mospërputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Gjirokastër **ka kthyer përgjigje** zyrtare në KLSH në tejkallim të afatit 20 ditor (pas 10 javësh) nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

Zbatuar pjesërisht

2.5.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

- Bashkia Gjirokastrë i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre. Sipas Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA. Nga auditimi rezultoi se ky raportim **nuk është bërë**.

Pa Zbatuar

- Bashkia Gjirokastrë **nukka raportuar** në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së”.

Pa Zbatuar

2.5.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronjat a) dhe b), nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, si dhe rekomandimet e pazbatuara, si më poshtë:

Janë lënë 16 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe 2 masa janë zbatuar, 5 masa janë në proces zbatimi; 7 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa pa zbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm është rikërkuar zbatimi për 12 masa organizative të cilat janë pranuar nga subjekti, nga të cilat 1 masë është zbatuar; 3 masa janë në proces zbatimi; 6 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa janë pazbatuar;

Në total janë lënë 28 masa organizative, nga të cilat 3 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi, 13 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 4 masa janë pazbatuar;

Janë lënë 2 masa për shpërblim dëmi, në vlerën totale 7,874,723 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar pjesërisht;

Nga auditimi i mëparshëm është rikërkuar zbatimi për 5 masa në vlerën totale 22,529,874 lekë, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe nga të cilat 1 masë në vlerën 1,121,654 lekë është pazbatuar, 3 masa në vlerën 20,659,092 lekë janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë në vlerën 749,128 lekë rezulton e zbatuar.

Në total janë lënë 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 30,404,597 lekë, nga të cilat 1 masë në vlerën 749,128 lekë është zbatuar, 1 masë (rikërkuar) në vlerën 1,121,654 lekë është pazbatuar dhe 5 masa në vlerën 28,533,815 lekë janë zbatuar pjesërisht.

Është lënë 1 masë për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj., (të ardhura të munguara), në vlerën totale 181,012,983 lekë, e cila është në proces zbatimi;

Nga auditimi i mëparshëm nuk është lënë masë për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj.;

Në total është lënë 1 masë në masën 181,012,983 lekë, e cila është në proces zbatimi;

Janë lënë 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa janë pazbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm është rikërkuar zbatimi për 6 masa nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 5 masa janë në proces zbatimi;

Në total, janë lënë 10 masa për eliminimin e efekteve negative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe nga të cilat 1 masë është zbatuar, 5 masa janë në proces zbatimi, 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa janë pazbatuar.

Masa disiplinore nuk janë lënë.

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm është si më poshtë:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Gjirokastër 28 masa organizative nga të cilat 16 masa janë lënë nga auditimi i fundit dhe 12 masa janë rikërkuar. Nga auditimi rezultoi se janë pranuar plotësisht të gjitha masat, nga të cilat 3 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi, 6 masa janë zbatuar pjesërisht, 4 masa janë pa zbatuar dhe 7 masa do të rikërkohen (pa verifikuar).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga ana e Bashkisë Gjirokastër janë marrë masat dhe është hartuar strategjia e riskut nga çdo drejtori: nr. 12315, nr. 12311, nr. 12240, nr. 12237 prot, datë 26-27.12.2023, por nuk është miratuar e unifikuar për gjithë institucionin; rezulton gjithashtu se gjurmët e auditimit nuk janë miratuar. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e financës dhe buxhetit ka marrë masat që me hartimin e PBA planeve vjetore të ketë në konsideratë të gjithë faktorët e mosrealizimit të buxheteve për dy vitet e fundit. Në PBA 2023-2025 dhe Planin vjetor 2023 miratuar me VKB nr. 100 datë 16.12.2022 dhe në PBA 2024-2026 dhe Planin vjetor 2024 miratuar me VKB nr. 119 datë 14.12.2023, janë evidentuar informacioni buxhetor i dy viteve paraardhëse 2021-2022-2023 si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet, me qëllim uljen e vlerës së mosrealizimit të buxhetit në vitet ushtrimore respektive. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti, është zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës dhe buxhetit nëpërmjet shkresave: nr. 5151 prot., datë 31.05.2023, nr. 9288 prot., datë 29.09.2023, nr. 1627 prot., datë 29.02.2024 ka vendosur në dijeni Këshillin Bashkiak mbi detyrimet e prapambetura, arsyet dhe ka hartuar grafikun e likuidimit të tyre sipas radhës. Pjesë e këtij grafiku janë bërë dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore, qira tokash, qira objekti dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës dhe buxhetit nëpërmjet shkresës nr. 12298 prot., datë 27.12.2023, ka kërkuar nga strukturat përgjegjëse DAPPLL dhe DU të bëjnë rakordimet për debitorët e taksave e tarifave të Bashkisë Gjirokastër. Deri tani nuk rezulton të jetë bërë rakordimi për të saktësuar vlerën totale të debisë nga taksat dhe tarifatat vendore, vërtetuar kjo nga mungesa e një akt rakordimi të përpiluar nga palët. Rrjedhimisht mungesa e akt rakordimit është shoqëruar edhe me moskontabilizimin e vlerës prej 59,718,570 lekë; ndërsa pjesa i përket ndjekjes së rrugëve administrative dhe ligjore nga strukturat përgjegjëse, kjo rezulton se janë marrë masat dhe është zbatuar. Pra **Rekomandimi 4.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Nga verifikimi u konstatua se: Nëpërmjet shkresës nr. 2428 prot., datë 28.03.2024 janë depozituar në Degën e Thesarit Gjirokastër pasqyrat financiare për vitin e mbyllur ushtrimor 2023, te të cilat vlera e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” kuadron me atë të llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Pra **Rekomandimi 5.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Financës dhe buxhetit ka marrë masat dhe në zbatim të Urdhrit nr. 721 datë 02.10.2023 dhe shkresën nr. 12249 prot., datë 27.12.2023, ka bërë saktësimet dhe sistemimet e nevojshme të konstatuara gjatë procedurës së inventarizimit fizik të aktiveve të bashkisë. Pra **Rekomandimi 6.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuar.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Financës ka marrë masa për të rritur bashkëpunimin me strukturat e tjera të bashkisë me qëllim mbledhjen e informacionit dokumentar mbi hyrjet e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, për të saktësuar vlerën e secilit aktiv e cila të përfshijë edhe shpenzimet e rikonstrukcioneve dhe mirëmbajtjes. Nëpërmjet shkresave: nr. 12298 prot., datë 27.12.2023, dhe nr. 3320, nr.3319, nr 3318, nr 3317, nr. 3316, nr. 3315, nr. 3314, nr. 3313 prot., datë 23.04.2024. Rezulton se shkresat për bashkëpunim kanë dalë pas hartimit të pasqyrave financiare, dhe rrjedhimisht **Rekomandimi 7.1** është pranuar nga subjekti por nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastër të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Gjirokastër dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllëgaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e financës dhe buxhetit janë marrë masat që me VKB nr. 113 datë 16.12.2022: “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Planit vjetor 2023 të Bashkisë Gjirokastër” janë përfshirë edhe fondet e planifikuara për regjistrimin e pronave të transferuara me VKM në Bashkinë Gjirokastër; Ndërsa janë në proces zbatimi përgatitja e

dosjeve për aplikim në ASHK. Pra **Rekomandimi 8.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, duke qenë se nga Drejtoria juridike po përgatiten dosjet për aplikim në ASHK për pajisje me titull pronësie të pronave të bashkisë, hapi vijues është rivlerësimi i tyre. Pra **Rekomandimi 9.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastrë, Cepo dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

Nga verifikimi u konstatua se: Bashkia Gjirokastrë nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Pra **Rekomandimi 10.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (*Njësia e Prokurimit*), për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret e vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Nga verifikimi u konstatua se: Gjatë vitit 2023 Bashkia Gjirokastrë ka parashikuar 96 procedura prokurimi nga të cilat 46 janë blerje me vlerë të vogël [BVV] dhe ka realizuar 61 procedura nga të cilat 33 janë BVV. Mbi korrektësinë e zbatimit të kërkesave për procedurat e hapura (kryesisht por jo vetëm) grupi i auditimit nuk mund të shprehet, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 11.1** është pranuar nga subjekti dhe do të rikërkohet.

11.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Kryetari i Bashkisë nëpërmjet Urdhrit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, është udhëruar Drejtoria e Urbanistikës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë

nivelin e zbatimit të tyre, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra Rekomandimi 11.2 është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar pjesërisht*.

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për:

- Të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rilevimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

- Lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

- Të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar që planvendosjen të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konformë kushteve teknike të projektimit.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Urbanistikëska marrë masat dhe nëpërmjet Urdhrit të titullarit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, ka urdhëruar punonjësit sipas pozicionit dhe detyrave të ndara sipas përshkrimit të punës, për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë nivelin e zbatimit të tyre, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 12.1** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar pjesërisht*.

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Urbanistikëska marrë masat dhe nëpërmjet Urdhrit të titullarit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, ka urdhëruar punonjësit sipas pozicionit dhe detyrave të ndara sipas përshkrimit të punës, për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë nivelin e zbatimit të tyre, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 13.1** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar pjesërisht*.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Urbanistikëska marrë masat dhe nëpërmjet Urdhrit të titullarit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, ka urdhëruar punonjësit sipas pozicionit dhe detyrave të ndara sipas përshkrimit të punës, për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë nivelin e zbatimit të tyre, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 14.1** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar pjesërisht*.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 731/37 prot datë 2.6.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Gjirokastrë”, konkretisht për rekomandimet si vijon:

A. Masa organizative.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga DAPPLL Bashkia Gjirokastrëderi tani nuk janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi 15/7.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandimi: *Bashkia Gjirokastrë të marrë masat e duhura për një planifikim sa më të studiuar të zërave buxhetor të shpenzimeve, duke eliminuar diferencat e dukshme midis vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar për këto zëra.*

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka marrë masat dhe në hartimin e PBA dhe Planeve vjetore e ka marrë në konsideratë këtë rekomandim. Pra **Rekomandimi 15/8.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

9.1. Rekomandimi: *Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.*

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/9.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

11.1. Rekomandimi: *Komisionet e vlerësimit të ofertave dhe titullari i autoritetit kontraktor, të eliminojnë praktikën e shpalljes fitues të një operatori ekonomik, për më shumë se një procedurë, në rastet kur procedurat zhvillohen njëkohësisht si afat kohor dhe operatori ekonomik nuk plotëson të gjitha kriteret e DST për të dy procedurat njëkohësisht.*

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/11.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

12.1. Rekomandimi: *Hartuesit e kriterëve të veçanta të DST dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrin masa që hartimi i kriterëve të jetë i argumentuar dhe të ketë lidhje të ngushtë midis tyre dhe objektivit të kontratës.*

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/12.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

13.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë 14,664,580 lekë që subjektet të ndryshëm i detyrohen Bashkisë Gjirokastrë, duke mos krijuar vonesa në kohë në ndjekjen e procedurave për këtë qëllim.*

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi 15/13.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

13.2. Rekomandimi: *Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrë masat për kontabilizimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në vlerën 110,777 mijë lekë.*

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi 15/13.2** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

16.1. Rekomandimi: *Drejtorja e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që pas miratimit të lejeve të*

ndërtimit, të mbahen aktet e kontrollit për zbatimin e tyre në terren në përputhje me lejen e ndërtimit.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Për periudhën tetor 2021 e në vijim nga një informacion i IMTV rezulton se është zbatuar. Pra **Rekomandimi 15/16.1** është pranuar nga subjekti është zbatuar.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të llogaritjes së fondit limit, të marrë masa që në rastet e prokurimeve për karburant, të llogarisë saktë vlerën e fondit limit, për të mos angazhuar fonde buxhetore më tepër nga sa duhen, me qëllim shpërndarjen e fondeve në mënyrë proporcionale me nevojat reale sipas zërave buxhetor të shpenzimeve.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/18.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të marrë masa që gjatë hartimit të tyre të bëhen argumentimet e duhura teknike dhe ligjore, me qëllim që çdo kriter i kërkuar të ketë lidhje të ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/19.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të specifikimeve teknike, të marrë masa për eliminimin e rasteve të cilat përmbajnë në specifikimet teknike të tenderit, përcaktime të markës, origjinës, si dhe përcaktime të tjera maksimale apo minimale, të cilat nuk janë të nevojshme dhe sjellin orientimin e ofertuesve drejt markave specifike prodhuese apo drejt distributorëve specifik të mallrave, kufizim të pjesëmarrjes së OE etj.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, por grupi i auditimit nuk jep dot një vlerësim mbi statusin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 15/9.1** është pranuar nga subjekti dhe do rikërkohet.

18. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Gjirokastrë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2018 – 30.06.2021, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Kryetari i Bashkisë deri tani nuk rezulton të jetë bërë raportim në Këshillin Bashkiak mbi gjetjet dhe Rekomandimet e lëna nga KLSH dhe përcjellë në RPA. Pra **Rekomandimi 15/18.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.⁴

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastrë,

⁴ Meqenëse ky rekomandim është i njëjtë me rezultatin e verifikimit për (mos)raportimin e Rekomandimeve të lëna në RPA të fundit në KB, do të përfshihet në një rekomandim të vetëm.

duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,121,654** lekë, respektivisht:

-Vlera **1,121,650** lekë, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999** lekë, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga strukturat përgjegjëse është vlerësuar rekomandimi dhe janë marrë masat për zbatimin e tij në investimet e periudhave në vijim, ndërsa për këto dy investime deri tani nuk është zbatuar. Pra **Rekomandimi 15/1.1** është pranuar nga subjektidhenuk është zbatuar

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447** lekë pa TVSh nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera. Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Financës dhe ajo Ligjore ka marrë masa dhe me shkresën nr. 11932/1 prot., datë 15.12.2023 ka njoftuar Subjektin “A.” shpk për punime të pakryera në vlerën 296,447 lekë. Deri tani subjekti nuk ka bërë asnjë arkëtim të plotë apo pjesor për llogari të Bashkisë Gjirokastrë. Pra **Rekomandimi 15/2.1** është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

C. Masa për shpërblim dëmi.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 17,195,325 lekë pa TVSh nga BOE “B.” ShPK & “A.K.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjetësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat dhe me shkresën nr. 4046 prot., datë 26.04.2023 është njoftuar BOE “B.” shpk (dhe & “A.K.” ShPK & “M.” ShPK) për arkëtimin e shumës prej 17,195,325 lekë për punime të pakryera. Deri tani nga ana e BOE nuk është bërë asnjë arkëtim pjesor apo i plotë për llogari të Bashkisë Gjirokastrë. Pra **Rekomandimi 15/1.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320** lekë pa TVSh nga BOE “N.S.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavi”.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat dhe me shkresën nr. 4046/2 prot., datë 26.04.2023 është njoftuar BOE “N.S.” ShPK (& “S.” ShPK), për arkëtimin e shumës prej 3,163,320lekë. Deri tani nga ana e BOE nuk është bërë asnjë arkëtim pjesor apo i plotë për llogari të Bashkisë Gjirokastrë. Pra **Rekomandimi 15/2.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **749,128** lekë nga kontraktori “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës me nr. 7359, datë 01.07.2022, me “Blerje kontejnerësh për mbetjet urbane”, Bashkia Gjirokastrë, për mos përmbushje të afatit të kontratës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Statusi: Në proces zbatimi

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë janë marrë masat dhe me shkresën nr. 4046/1 prot., datë 26.04.2023 është njoftuar Kontraktori “E.” ShPK për arkëtimin e shumës prej 749,128 lekë. Deri tani nga ana e kontraktorit nuk është bërë asnjë arkëtim pjesor apo i plotë për llogari të Bashkisë Gjirokastrë.

Nga ana e kontraktorit, janë ndërmarrë hapa ligjore dhe me Vendimin nr. rregj. them 457/31123-00383-85-2023 datë 15.05.2023 Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë është shprehur në favor të paditësit “E.” Shpk. Bashkia Gjirokastrë e ka apeluar vendimin. Vendimi që do të marrë Gjykata e Apelit do të zbatohet. Pra **Rekomandimi 15/3.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 30.09.2021, në vlerën totale **217,929 mijë lekë**, e cila përbëhet nga:

-**98,398 mijë lekë** detyrime për taksën familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 4,498 familje;

-**23,553 mijë lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 3,590 familje;

-**59,875 mijë lekë** detyrime nga biznesi i vogël për 1,224 subjekte;

-**25,155 mijë lekë** detyrime nga biznesi i madh për 116 subjekte;

-**7,834 mijë lekë** kamatëvonesa biznesi i vogël;

-**3,113 mijë lekë** kamatëvonesa biznesi i madh;

Nga verifikimi rezultoi se:

Drejtoria e të Ardhurave për vitin 2022 me shkresën nr. 998 Prot date 01.02.2023 ka dërguar listën e subjekteve debitorë për vitet 2020-2021 për efekt kontabilizimi. Drejtoria e të Ardhurave ka arkëtuar nga masat shtrënguese (bllokime bankare) vlerën 15,899,973 leke për biznesit e madh dhe të vogël. Mbetet për arkëtim vlera **202,029,027 lekë**

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit (ky rekomandim përfshihet në Rekomandimin 1.1 të kategoria D- Masa për Uljen e Borxhit Tatimor). Pra **Rekomandimi 15/1.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 6,219,206 lekë** ndaj **229 personave**.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e të Ardhurave kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit (Ky rekomandim përfshihet në Rekomandimin 1.1 të kategorisë C- Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e të Ardhurave). Pra **Rekomandimi 15/2.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Gjirokastrë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

Nga verifikimi rezultoi se: Me ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ASHK autorizoi të aplikonte dhe përfundonte procedura pa kërkuar vërtetim mbi detyrimet e aplikantit në Bashkinë Gjirokastrë. Me përditësimet e kuadrit ligjor, procedurat që realizohen pranë ASHK kërkojnë vërtetim mbi detyrimet e taksa e tarifa vendore në Bashkinë Gjirokastrë. Pra **Rekomandimi 15/2.2** është pranuar nga subjekti dhe konsiderohet i zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 3,700,000 lekë**, nga katër subjekte (sipas tabelës në aneksin bashkëgjatur raportit të auditimit, pika 2.6).

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit (Ky rekomandim përfshihet në Rekomandimin 1.1 të kategorisë D- Masa për Uljen e Borxhit Tatimor). Pra **Rekomandimi 15/3.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në **vlerën 564,084 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e të Ardhurave ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit (Ky rekomandim përfshihet në Rekomandimin 1.1 të kategorisë D- Masa për Uljen e Borxhit Tatimor). Pra **Rekomandimi 15/4.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

5.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin që për gjodat të cilat nuk janë paguar në mënyrë vullnetare dhe ju ka kaluar afati ligjor i pagesës, në vlerën **2,000,000 lekë** sipas aneksit, bashkëlidhur raportit të auditimit, të bëjë adresimin e tyre në gjykatë për nxjerrjen e urdhër ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobës.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga IMTV Gjirokastër janë përcjellë në Drejtorinë Juridike gjodat e vendosura për vitet 2022 dhe 2023 të cilat nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësi. Kështu situata e tyre deri në 31.12.2023 ku përfshihen gjodat e vendosuar nga IMTV nga viti 2018 deri në vitin 2022, është si më poshtë:

| Gjoda | Numër | Vlerë | Statusi |
|---------------|------------|-------------------|---------|
| viti 2018 | 9 | 1,825,000 | |
| Viti 2019 | 31 | 7,700,000 | |
| Viti 2020 | 35 | 12,700,000 | |
| Viti 2021 | 12 | 5,100,000 | |
| Viti 2022 | 19 | 6,450,000 | |
| Totali | 106 | 30,300,000 | |

Pra nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se për gjodat e vendosura në periudhën 2018-2021 ende nuk janë dërguar në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv; debia progresive është 30,300,000 lekë; arkëtimet kanë qenë për gjoda të vendosura në vitin 2022. Pra **Rekomandimi 15/5.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastër, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Urbanistikëska marrë masat dhe nëpërmjet Urdhrit të titullarit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, ka urdhëruar punonjësit sipas pozicionit dhe detyrave të ndara sipas përshkrimit të punës, për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë nivelin e zbatimit të tyre, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 16.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht.

B. Masa shpërblim dëmi.

Masa shpërblim bëmi janë lënë 7 masa në vlerën totale 22,567,174 lekë , nga të cilat 2 masa janë lënë në RPA nga auditimi i fundit dhe 5 masa janë rikërkuar. Këto masa janë pranuar plotësisht nga Bashkia Gjirrokastër, nga të cilat 5 masa janë zbatuar pjesërisht në vlerën totale 28,530,815 lekë, 1 masë është zbatuar në vlerën 749,128 lekë, 1 masë është pazbatuar në vlerën 1,121,654 lekë.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH-së”, shkronjat b) dhe c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e bëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e bëmit në vlerën **7,874,723 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirrokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të JV “N.” & “K.” ShPK, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Drejtoria e Financës/Bashkia Gjirrokastër janë marrë masat dhe me shkresën nr. 11932 prot., datë 15.12.2023 është njoftuar JV " N. " & " K." ShPK, për arkëtimin e shumë prej 43,300lekë si diferencë punimesh të pakryera. Deri tani nga ana e JV nuk është bërë asnjë arkëtim pjesor apo i plotë për llogari të Bashkisë Gjirrokastër. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirrokastër të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuajuara por të parealizuara.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirrokastër për zbatimin e rekomandimit nuk rezulton ndonjë masë konkrete për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Grupi i auditimit nuk mund të verifikojë nivelin e zbatimit të tij, pasi nuk është përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 2.1.** është pranuar nga subjekti dhe do të rikërkohet.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave.

Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e të Ardhurave janë lënë 10 masa, nga të cilat 4 masa janë lënë në RPA nga auditimi i fundit dhe 6 masa janë rikërkuar, të cilat subjekti i ka pranuar plotësisht. Nga këto masa rezulton se 5 masa janë në proces zbatimi (të rikërkua) në vlerën totale 214,512,317 lekë⁵, 1 masë zbatuar pjesërisht në vlerën 1,854,317 lekë, 1 masë është e zbatuar, 2 masa janë pazbatuar në vlerën 1,972,105 lekë dhe 1 masë do rikërkohet (mungesë informacioni).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirrokastër, Drejtoria Planifikim Zhvillim Territori, të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim, listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 84 personame vlerë **1,854,317 lekë**.

Nga verifikimi u konstatua se: Drejtoria e Urbanistikëska marrë masat dhe nëpërmjet Urdhrit të titullarit nr. 892/1 datë 12.12.2023 me nr. 1176/1 prot., datë 12.12.2023, ka urdhëruar

⁵ Këtu janë përfshirë dhe 3 masa: R15/2.1, R15/3.1 dhe R15/4.1 në vlerën totale prej 204,029,027 lekë, të cilat kategorizohen në Grupin D – Masa për Uljen e Borxhit Tatimor.

punonjësit sipas pozicionit dhe detyrave të ndara sipas përshkrimit të punës, për të zbatuar rekomandimin e lënë nga KLSH. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti, është zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

| Viti | Numri i debitoreve | Vlera totale | Statusi aktual |
|-----------------------|--------------------|--------------|----------------|
| 31.12.2021 progresive | 64 | 1,528,969 | debitore |
| 31.12.2022 progresive | 76 | 1,690,840 | debitore |
| 31.12.2023 progresive | 85 | 1,903,345 | debitore |

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në Drejtorin e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës **1,072,105 lekë**.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga Bashkia Gjirokastrë është vlerësuar rekomandimi por deri tani nuk rezulton të jenë marrë masat për zbatimin e plotë të tij. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të marrë masa për ristrukturimin e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit me personel të kualifikuar arsimorë sipas depozitave ligjore.

Nga verifikimi u konstatua se: Struktura organizative e Bashkisë Gjirokastrë për vitet 2023 dhe 2024 e miratuar me Vendim nr. 98 datë 16.12.2022, rezulton se deri tani njësia e IMTV-së nuk ka pësuar ndryshime cilësore dhe sasiore. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

3.2. Rekomandimi: IMTV Gjirokastrë të marrë masa për:

- Kryerjen e kontrolleve në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga Kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike.

- Të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik.

- Marrjen e masave për arkëtimin e penaltetit në masën 2% per çdo ditë vonesë në shumën 900,000 lekë ndajë 2 subjekteve të cilat nuk kanë likuiduar në afat, respektivisht: “E.H.” në shumën **300,000 lekë** dhe subjektin “M., G.C.” në shumën **600,000 lekë**.

- Për të gjitha rastet e shkeljeve të lejes së ndërtimit të kërkohet heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë.

- Të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm.

Nga verifikimi u konstatua se: Nga IMTV janë marrë masat për të zbatuar rekomandimin. Grupimi auditimit nuk mund të japë një vlerësim mbi nivelin e zbatimit pasi nuk është e përfshirë në programin e auditimit. Pra **Rekomandimi 3.2** është pranuar nga subjekti dhe do të rikërkohet.

D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

Masa për *Uljen e Borxhit Tatimor (të Ardhura të Munguara)* është lënë 1 masë në RPA nga auditimi i fundit në vlerën totale 181,012,983 lekë (janë 1032 subjekte debitore në vlerën 70,197,983 lekë, 64 subjekte për qira objekte tregu në vlerën 2,526,000 lekë, 11345 familje debitore në vlerën e debisë 108,289,000 lekë) e cila rezulton në proces zbatimi.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimeve vlerësimet tatimore për debitorët duke

ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 181,012,983lekë.

Nga verifikimi u konstatua se: Bashkia Gjirokastrë ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Situata ka përmirësime dhe një pasqyrim i saj jepet në tabelën mëposhtë. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe pjesa e pazbatuar është në proces zbatimi.

| Nr. | Emërtimi | Debitorë | Debia 2022 | Nr. i pagesave | Vlera e paguar | Gjendje nga 2022 | Debitorë 31.12. 2023 | Debia 2023 | Debia progresive 31.12.2023 |
|---------------|-----------|---------------|--------------------|----------------|-------------------|--------------------|----------------------|-------------------|-----------------------------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5= (2-4) | 6 | 7 | 8=(5+7) |
| 1 | Familjarë | 11,485 | 88,088,383 | 11,283 | 37,163,231 | 50,925,152 | 11,794 | 40,790,000 | 91,715,152 |
| 2 | B. Madh | 104 | 21,550,391 | 75 | 8,952,589 | 12,597,802 | 59 | 3,910,389 | 16,808,191 |
| 3 | B.Vogël | 928 | 48,647,593 | 437 | 11,436,406 | 37,211,187 | 906 | 12,421,184 | 49,632,371 |
| Totali | | 12,517 | 158,286,367 | 11795 | 57,552,226 | 100,734,141 | 12,759 | 57,121,573 | 158,155,714 |

| Përshkrimi | Nr. | Borxhi progresiv 31.12.2022 | Nr. | Borxhi 2023 | Nr. | Borxhi progresiv 31.12.2023 |
|---|---------------|-----------------------------|--------------|-------------------|---------------|-----------------------------|
| Debitorë biznes i madh | 104 | 21,550,391 | 30 | 310,394 | 59 | 16,808,191 |
| Debitorë biznes i vogël | 928 | 48,647,593 | 415 | 61,488 | 906 | 49,632,371 |
| Nëntotali I | 1032 | 70,197,984 | 445 | 371,882 | 965 | 66,440,562 |
| Debitorë taksa e ndërtesës familje dhe Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim, sh.varreza) | 11,485 | 88,088,383 | 11,592 | 40,790,000 | 11,794 | 91,715,152 |
| Debitorët taksa e tokës bujqësore | 4974 | 22,062,198 | 4722 | 2,017,024 | 6922 | 19,362,272 |
| Debitorët taksa e ndikimit në infrast. | 76 | 1,690,840 | 9 | 162,160 | 85 | 1,903,345 |
| Debitorët nga qiratë | 17 | 429,318 | 33 | 741,846 | 45 | 1,097,732 |
| Nëntotali II | 16552 | 112,270,739 | 16356 | 43,711,030 | 18,846 | 114,078,501 |
| Total Borxhi tatimor | 17,584 | 182,468,723 | | | 19811 | 180,519,063 |

E. Masa disiplinore.

Në lidhje me masa disiplinore nuk rekomandojmë pasi për të njëjtat shkelje të evidentuara në periudhën e auditimit 01.10.2022 – 31.12.2022, për punonjësit përgjegjës janë rekomanduar masa disiplinore në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 28, datë 23.01.2023, “Mbi auditimin e realizuar për periudhën 01.01.2021 – 31.10.2022”, të cilat subjekti Bashkia Gjirokastrë i ka zbatuar në masën 100%.

Konkluzion:

Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga **46** rekomandime të lëna, nga Subjekti Bashkia Gjirokastrë janë pranuar të **46** rekomandime nga të cilat janë verifikuar vetëm **31** masa, ndërsa 15 masa për shkak të natyrës së tyre specifike janë në pamundësi verifikimi (referuar programit të auditimit financiar): janë zbatuar **5** masa ose **16.2%** e tyre; **20** masa janë zbatuar pjesërisht (9 masa janë të grupit të paverifikuara); **14** masa janë në proces zbatimi si dhe **7** masë është pa zbatuar; pra **27** masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Gjirokastrë për periudhën në vijim.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga Bashkia Gjirokastrë (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që:

- Për kategorinë “Masa Organizative”- Rekomandimet R 1.1; R 2.1; R 3.1; R 5.1; R 6.1; R 8.1; R 9.1; dhe nga Rekomandimet e rikërkuara - R 15/8.1; R 15/13.1; R 15/13.2; R 15/16.1;
- Kategorinë “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave”- Rekomandimet e rikërkuara R 15/1.1; R 15/2.1; R 15/2.2; R 15/3.1; R 15/4.1 dhe R 15/5.1;
- Kategorinë “Masa shpërblim dëmi” të konstatuara në përdorimin e fondeve publike për investimet e kryera - Rekomandim i rikërkuar 15/3.1 në vlerën 749,128 lekë;
- Kategorinë “Masa ulje e borxhit/të ardhura të munguara”- Rekomandimi i të cilës përfshihet në trajtimin e pikës nr. 2.6 të programit të auditimit janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga Bashkia Gjirokastrë, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

2.6. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

Gjatë zhvillimit të auditimit në terren, nuk pati çështje të tjera për të audituar.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori.

Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nën-pikat 1-5, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pikat 2.2.6., 2.5.2., Kapitulli III, pikat 3.1. dhe pika 3.2., hapi 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se planifikimi fillestar i buxhetit për zërin shpenzime nga vlera 1,435,644 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,156,416 mijë lekë ose 80.5, për shkak të mosanalizimit të shkaqeve që kanë shkaktuar të njëjtat situata në vitet e mëparshme, për mosrealizim të të ardhurave dhe për planifikim të investimeve pa hartuar më parë projektet përkatëse.

Nga auditimi, u konstatua se në hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit nuk është specifikuar ndarja dhe mënyra e financimit, se sa përqind e vlerës do të mbulohet me fondet e veta, sa nga buxheti i shtetit dhe sa me fonde të tjera.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 50-51 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 3, pika 2; pika 101 dhe 102 të UMFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat

standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; neni 47 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike në Bashkinë Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, në mënyrë që të realizohen të gjitha procedurat e prokurimit për punë publike në shërbim të komunitetit, të marrin masa që në asnjë rast të mos parashikohen prokurime për punë publike pa pasur paraprakisht të disponueshëm projektin përkatës, me të gjitha detajet sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gjirokastër informacionin tatimor e përpunon në programin EXCEL. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor për të ardhurat vendore, sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.;

Bashkia Gjirokastër nuk ka pasur bashkëpunim me ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër për të marrë informacion mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër me vlerën e përlllogaritur. Deri në datën 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastër për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE;

Bashkia Gjirokastër nuk ka regjistruar në paketën fiskale të saj si burim të ardhurash, “rentën minerare” dhe në mungesë të informacionit, DAPPLL nuk ka bërë as akt rakordimet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në moszbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 7 datë 014.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; (referuar edhe “Miratimi i vlerave referuese” nga Ministria e Financave nr. 16365 prot., datë 17.10.2012 dhe Vendimi i Komisionit AD-HOC për rentën minerare).

Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë, mbajtjen e aktrakordimeve me ta dhe krijimin e një databaze me të dhënat përkatëse nga agjentët;

Nga analiza e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023, rezultoi si më poshtë:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 4,000 mijë lekë dhe është mundur të vilet 4,464 mijë lekë ose 112% e vlerës së planifikimit, me një rënie prej 246 mijë lekë më pak se në vitin 2022;
- Taksa e rentës minerare, nuk është parashikuar për dy vite radhazi 2022 dhe 2023, dhe rezulton se nuk është vjelë për asnjë vit. DAPPLL nuk e ka ndjekur arkëtimin e saj nga subjektet duke mos bërë rakordimet me Drejtorinë e Doganës dhe Drejtorinë e Tatimeve.
- Taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 724 mijë lekë dhe realizuar në shumën 477 mijë lekë ose në masën 66%. Duhet theksuar se për vitin paraardhës 2022 vlera e arkëtimeve nga kjo taksë për llogari të Bashkisë Gjirokastrë ka qenë më e lartë në shumën 3,489 mijë lekë;
- Leje shfrytëzim karburanti është parashikuar në shumën 2,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 650 mijë lekë ose në masën 33%, por rezulton se krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rënie në shumën 350 mijë lekë;
- Qira tregu Agro ushqimor është parashikuar 2,292 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,603 mijë lekë ose në masën 70%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 889 mijë lekë;
- Qira tokë bujqësore është parashikuar 757 mijë lekë dhe realizuar në shumën 545 mijë lekë ose në masën 72%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje prej 148 mijë lekë më shumë.

Mos realizimi i të ardhurave ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave periodike dhe vjetore mbi mosrealizimin tyre, mosraportimit nga ana e strukturave përgjegjëse të planifikimit vjetor e çdo takse/tarife përkatëse për hartimin e paketës fiskale të vitit pasardhës, mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes strukturave përgjegjëse që sigurojnë të ardhura duke mos u administruar në kohë informacioni tatimor nga ana e DAPPLL.

Nga Titullari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka asnjë analizë të situatës së tre subjekteve që janë pajisur me leje për tregëtim karburanti dhe hidrokarbure: “A.N.”, “F.2.” dhe “E.G.”, Ura e Lumit, për marrjen e masave me qëllim zgjidhjen shteruese të ngërçit të krijuar nga mospagesat e kryera prej tyre, dhe për subjektin “K.S.”, Shtepëz, i cili ushtron aktivitetin e vet te territori i braktisur nga subjekti “F.2.” për të cilin nga auditimi dhe komunikimi me DAPPLL, rezulton informacion jo i plotë dokumentar mbi praktikën e dhënies së lejes për ushtrimin e aktivitetit për periudhën nga 2020 e në vijim, mosveprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, (konstatuar edhe nga grupi i auditimit të mëparshëm, për të cilin është lënë dhe rekomandim).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukurore, për mirëadministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit;

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave të marrin masa për:

- Planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;
- Të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimorë sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Gjirokastrë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimorë nuk realizojnë dhe pasqyrojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Gjirokastrë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;
- Të bëjnë pjesë të Paketës Fiskale “të ardhurat nga renta minerare”, si e ardhur në buxhetin e bashkisë nga aktiviteti që ushtrohet në territorin e saj për shfrytëzimin e mineraleve.
- Të caktojë në strukturën e DAPPLL një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se janë pajisur me certifikata pronësie 10 aktive/pasuri, të llojeve kullotë, pyll, truall dhe ndërtesë, për të cilat u konstatua se pavarësisht regjistrimit në AShK, nuk është bërë vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

Nga auditimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, rezultoi se llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota dhe plantacione*”, 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, nuk janë të analizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, ku të specifikohet informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Gjithashtu, nga Bashkia Gjirokastrë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë Aktiveve Afatgjata Materiale të transferuara në pronësi apo në përdorim ish komunave të konsoliduara aktualisht në Bashkinë Gjirokastrë.

Këto veprime janë në kundërshtim me neni 6, VKM-në nr. 510, datë 14.08.2001, “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, pika 1 dhe 2, VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive*”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pikat 26-30, pika 35, gërmat “a”, “b” dhe “c”, pika 74 dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*”, Kreu II, pika 5, 36 dhe Kreu III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 38-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masat për vlerësimin dhe regjistrimin në kontabilitet të të gjitha Aktiveve Afatgjata Materiale, përfshirë asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Vlerësimi i aseteve të bëhet për vlerën reale, sipas zonave kadastrale dhe të regjistruhen si pasuri e saj në AShK, dega Gjirokastrë.

Menjëherë

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve të Bashkisë me të gjitha kërkesat e formatit të miratuar, për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirëmenaxhimin e tyre.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Gjirokastrë, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njësisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njësisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastrë”, i janë miratuar listat e inventarit të Pasurive Publike, ndërsa Njësisë Administrative Lunxhëri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njësisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njësisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njësisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar pronat publike në pronësi dhe përdorim.

Për pronat e transferuara si më sipër, nga Sektori i Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk është bërë regjistrimi në ASHK, nuk janë inventarizuar, nuk janë vlerësuar, nuk janë kontabilizuar dhe nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale të këtyre pronave, sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26 dhe 27 dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 47-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative për të cilat është miratuar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, me qëllim përfundimin e procedurës së transferimit, si dhe për pronat të cilat janë transferuar, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve, etj., me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë ka miratuar Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit”, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 në Bashkinë Gjirokastrë. “Plani i veprimi” është dërguar në KLSH me shkresën nr. 11761/1 prot., datë 21.12.2023 në tejkallim të afatit 20 ditor, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin e strukturave të ngarkuara me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në mospërputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Gjirokastrë ka kthyer përgjigje zyrtare në KLSH në tejkallim të afatit 20 ditor (pas 10 javësh) nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e

rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërbllim dëmi.

- Bashkia Gjirokastrë i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre. Sipas Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA. Nga auditim rezultoi se ky raportim **nuk është bërë**.

- Bashkia Gjirokastrë **nuk ka raportuar** në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së”.

a. Masa Organizative janë lënë **28** Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohen **17** masa: **13** pjesërisht të zbatuara dhe **4** të pazbatuara;

b. Masa shpërbllim dëmi janë lënë **6** rekomandime në vlerën 29,655,464 lekë dhe rikërkohen në vlerën e plotë si të zbatuara pjesërisht **4** masa në vlerën totale 28,233,368 lekë dhe **2** masa të pazbatuara në vlerën 1,422,096 lekë ;

c. Masa me efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **10** masa (6 masa të rikërkua) nga të cilat rikërkohen **2** masa të pazbatuara dhe **2** masa zbatuar pjesërisht;

d. Masa për ulje të borxhit/të ardhura të munguara është lënë **1** masë në vlerën 181,012,983 lekë, e cila është në proces zbatimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 51-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 519/7 prot., datë 11.10.2023 dhe regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë me nr. 9728 prot., datë 12.10.2023 si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 07.06.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të atyre pjesërisht të zbatuara dhe të pazbatuara si vijon:

Menjëherë

A. Masa organizative

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore, qira tokash, qira objekti dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të pa analizuar.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastrë, Cepo dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), për procedurat e prokurimit që do

të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

11.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për:

- Të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rilevimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

- Lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

- Të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar që planvendosjen të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konformë kushteve teknike të projektimit.

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

15/7.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

15/9.1. Rekomandimi (rikërkuar): Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

15/11.1. Rekomandimi (rikërkuar): Komisionet e vlerësimit të ofertave dhe titullari i autoritetit kontraktor, të eliminojnë praktikën e shpalljes fitues të një operatori ekonomik, për

më shumë se një procedurë, në rastet kur procedurat zhvillohen njëkohësisht si afat kohor dhe operatori ekonomik nuk plotëson të gjitha kriteret e DST për të dy procedurat njëkohësisht.

15/12.1. Rekomandimi (rikërkuar): Hartuesit e kriterëve të veçanta të DST dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrin masa që hartimi i kriterëve të jetë i argumentuar dhe të ketë lidhje të ngushtë midis tyre dhe objektit të kontratës.

15/18.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të llogaritjes së fondit limit, të marrë masa që në rastet e prokurimeve për karburant, të llogarisë saktë vlerën e fondit limit, për të mos angazhuar fonde buxhetore më tepër nga sa duhen, me qëllim shpërndarjen e fondeve në mënyrë proporcionale me nevojat reale sipas zërave buxhetor të shpenzimeve.

15/19.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të marrë masa që gjatë hartimit të tyre të bëhen argumentimet e duhura teknike dhe ligjore, me qëllim që çdo kriter i kërkuar të ketë lidhje të ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

15/21.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet strukturave përkatëse të hartimit të specifikimeve teknike, të marrë masa për eliminimin e rasteve të cilat përmbajnë në specifikimet teknike të tenderit, përcaktime të markës, origjinës, si dhe përcaktime të tjera maksimale apo minimale, të cilat nuk janë të nevojshme dhe sjellin orientimin e ofertuesve drejt markave specifike prodhuese apo drejt distributorëve specifik të mallrave, kufizim të pjesëmarrjes së OE etj.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të JV “N.” & “K.” ShPK, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të porealizuara.

Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastrë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,125,649 lekë**, respektivisht:

-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999 lekë**, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashkuar” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSh** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Për 2 Masa për shpërblim dëmi në vlerën totale 20,358,645 lekë si vijon:

15/1.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.K.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjiellësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

15/2.1. Rekomandimi (rikërkuar): Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.S.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavi”.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës **1,072,105 lekë**.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të marrë masa për ristrukturimin e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit me personel të kualifikuar arsimorë sipas deponitave ligjore.

3.2. Rekomandimi: IMTV Gjirokastrë të marrë masa për:

- Kryerjen e kontrolleve në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga Kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike.

- Të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik.

- Marrjen e masave për arkëtimin e penaltetit në masën 2% per çdo ditë vonesë në shumën 900,000 lekë ndajë 2 subjekteve të cilat nuk kanë likuiduar në afat, respektivisht: “E.H.” në shumën **300,000 lekë** dhe subjektin “M., G.C.” në shumën **600,000 lekë**.

- Për të gjitha rastet e shkeljeve të lejes së ndërtimit të kërkohet heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë.

- Të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjomat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe

zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshëm.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se: 15 subjekte kanë kryer pagesë të plotë të detyrimit deri në datën 31.12.2022 në vlerën totale 14,400,000 lekë; 2 subjekte, “E.G.” dhe K.S.”, e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 2 vendndodhje të ndryshme (kanë 2 pika shitje karburanti) dhe kanë bërë pagesë të pjesshme të detyrimit deri në datën 31.12.2023, në vlerën totale 550,000 lekë për një prej pikave, nëpërmjet Akt Marrëveshjeve të lidhura me Bashkinë Gjirokastrë; “K.S.”, Shtepëz në vitin 2020 ka nisur aktivitetin e tij në territorin dhe mjetet e instaluar teknike të aktivitetit që ka patur subjekti “F.2.”;

- për subjektet “F.2.”, Shtepëz dhe “E.G.”, Ura e lumit, nga ana e DAPPLL nuk ka informacion mbi detyrimin referuar lejes së përfutur, pasi i përkasin periudhës 2015-2020 dhe 2018-2023 në të cilën përfshihen edhe ndryshimet ligjore mbi procedurat e pajisjes me leje subjekteve që tregëtojnë karburante dhe hidrokarbure dhe të lëvizjes së shpeshtë të personelit brenda strukturës së Drejtorisë gjatë kësaj periudhe;

- subjekti “A.N.” nuk ka paguar dhe nuk e njeh detyrimin prej 1,000,000 lekë;

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga DAPPLL rezulton se vetëm për 3 subjekte “E.G.”, “K.S.” Shtepëz dhe “A.N.” detyrimi në vlerën totale është 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë; ndërsa për 2 subjektet “E.G.” dhe “F.2.” nuk ka informacion mbi detyrimin e tyre ndaj Bashkisë Gjirokastrë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Liçencave, të analizojnë situatën specifike të subjekteve “E.G.”, “K.S.” Shtepëz dhe “A.N.” dhe të marrin masa për arkëtimin e vlerës 3,450,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

Për subjektet “F.2.”, Shtepëz dhe “E.G.”, Ura e lumit, të saktësojnë vlerën e detyrimit dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të njohur dhe paguar prej tyre vlerën e plotë të detyrimit për llogari të Bashkisë Gjirokastrë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Gjirokastrë, u konstatua se deri në datën

31.12.2022, borxhi tatimor ka qenë 182,468,723 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2023 ka qenë 60,042,603 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2023, janë 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, nga e cila janë kontabilizuar vetëm 15,931,835 lekë dhe vlera **166,587,228 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë.

Grupi i auditimit ka vlerësuar se detyrimi (progresiv) deri në datën 31.12.2023 për disa nga taksat dhe tarifave vendore kryesore përbëhet si më poshtë:

- Detyrime nga abonentët familjarë, në vlerën 91,715,152 lekë për 11794 debitorë;
- Detyrime nga kategoria biznes, në vlerën 66,440,562 lekë për 965 debitorë;
- Detyrime nga taksa e tokës bujqësore, në vlerën 19,362,272 lekë për 6922 debitorë;
- Detyrime nga TNI, në vlerën 1,903,345 lekë për 85 debitorë;
- Detyrime mbi dhënien me qira të tokave bujqësore, në vlerën 1,097,732 lekë për 45 debitorë;
- Debitorë problematikë (92), në shumën progresive 23,104,873 lekë.

(vlera e debitorëve problematikë është përfshirë në secilën vlerë debitore për taksa të ndryshme)

Në Bashkinë Gjirokastrë nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës progresive 180,519,063 lekë për 19,811 debitorë, veçanërisht ndaj nëntëdhjetë e dy (92) debitorëve problematikë për arkëtimin e shumës progresive 23,104,873 lekë.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Leje e Liçencave të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj;

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja rekomandohet dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit dhe **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe neni 37, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHITIT